

INTERVISTË ME AJET DULIN

Prishtinë | Data: 23 qershor, 2022

Kohëzgjatja: 153 minuta

Të pranishëm:

- Ajet Duli (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Nëse mundeni me u prezantu, emrin, mbiemrin, datën e lindjes, diçka për familjen, prejardhjen e juaj?

Ajet Duli: Jom Ajet Duli i lindur me 10 të tretit, në vitin 1954, në fshatin Svircë komuna e Medvegjës. Në fshatin Svircë e kom kry shkollën fillore, katër vjeçare. Kurse prej klasës së pestë deri në klasën e tetë e kom kry në Bajë të Sijarinës. Kemi qenë gjenerata e parë në gjuhën shqipe në Banjë të Sijarinës.

Anita Susuri: Ma herët nuk ka pasë?

Ajet Duli: Ma herët, vetëm serbisht. A na kemi qenë gjenerata e parë edhe kemi dalë klasën e tetë e kemi krye në '68-ën. Në vitin '68-'69 jom ardhë në Prishtinë, jom regjistru në Shkollën Normale. Kom qenë gjenerata e fundit e Normales me pesë vjeçare. Në '74-tën e kom kry Shkollën Normale, jom regjistru në vitin shkollor '74-'75 në Shkollën e Lartë Pedagogjike, grupi fizikë-kimi. E kom krye këtë fizikë kimi grupin edhe ia kom fillu në vitin 1976-77 kom punu në shkollën fillore, "Zenel Hajdini", në Topallë si arsimtar i fizikës dhe kimisë.

Anita Susuri: Po du m'u kthy pak ma mrapa për familjen e juaj me ju pytë. Çfarë familje keni qenë?

Ajet Duli: Familja ime osht' njihet si familja e Dul Gurgurovcit. Mbiemrin Gurgurovci përpara e kanë pasë familja jonë në bazë të vendit ku e kemi lshue, që na kanë ndjekë serbët në vitin, në vitin 1878, '77-'78. Ai fshati ku kanë qenë të parët tanë, Gurgurovci, është nër Lebanë. Nja katër kilometra nër Lebanë edhe ka qenë sipërfaqe krejt e rrafshët edhe toka shumë pjellore. Tregojnë, pleqtë kanë tregue kur kanë ikë prej Gurgurovcit, hambaret i kanë pasur të mbushura me grurë, koshet me kollomoç e tavanet me arra. Po prej krejt asaj pasurie vetëm gjanë e gjallë [bagëtinë] si kanë qenë i kanë marrë me veti edhe kanë dalë në Ferizaj.

Nga Ferizaji kanë dashtë të kthehen prapë në Gurgurovc. Ni familje jona sot, sot e kësaj dite gjindet në Ferizaj. Ata e kanë rujtë mbiemrin Gurgurovci. Ni familje në Krilevë është vendosë edhe sot e asaj dite kanë mbetë në Krilevë. Por, ata e kanë ndrru mbiemrin e kanë marrë mbiemrin Demolli. Kurse familja e Dulit, Dul Gurgurovcit u kthye në Svircë për m'u kthye në Gurgurovc, po s'i kanë lanë kurrë nihere edhe

kemi mbetë në qato male, në qato fusha. Në kushte të jashtëzakonshme të vështira. Ajo ka qenë në periudhë njëqind vjeçare që kemi jetu familja jonë në Svirçë po edhe aty do që kanë qenë, i kanë zanë edhe janë metë gjallë, gjallë e për kijamet siç thuhet. Në vitin '69 na e kemi shitë pasurinë aty çka e kemi pasë në Svirçë, jemi vendosë në Prishtinë, në shtator '69, shtator.

Anita Susuri: Po familjet e juja, për shembull që kanë jetu në atë pjesë, jashtë Kosovës me thanë. Qysh keni jetu ju? A keni pasë presione apo me çka jeni marrë?

Ajet Duli: Ndëgjo, atje te na sidomos në komunën e Medvegjës janë do fshate siç është Svirca, Gurboci, Ramabaja, Kapiti, Llapashtica. Fshatra shumë të pazhvilluara. A kjo Tupalla edhe qikjo hapësira prej Medvegje deri në Vllasë është në lugë, ajo lugina ka pasë kushte të mira për me jetue. Ne kemi luftu për një kafshatë bukë, si me sigurue ekzistencën familjare. Kushtet kanë qenë jashtëzakonisht të vështira.

Anita Susuri: A keni punu për shembull toka, a me çka jeni marrë?

Ajet Duli: Po me bujqësi edhe me blegtori.

Anita Susuri: Kjo shkuarja deri në shkollë, udhëtimi, qysh ka qenë për juve?

Ajet Duli: Në kamë ka qenë. Gjashtë kilometra ka qenë prej shtëpisë time deri në Banjë të Sijarinës. Përpara kanë qenë dimrat e vështirë, rajke bora të mdhaja, acar i madh. Dëshë e dathë. Unë e mbaj mend kur kom shku në klasë të parë, kom shku me do opinga të lëkurës së lopve, në klasë të parë.

Anita Susuri: A janë ble ato a janë maru?

Ajet Duli: Jo, janë maru.

Anita Susuri: A ju ka maru dikush i familjes?

Ajet Duli: Po. Çdo familje ka ditë me i bo ato, se atëherë kanë qenë kushtet jashtëzakonisht të vështira të jetesës. E mbaj mend niherë kom mbetë pak në Banjë të Sijarinës për me marrë do vaj, sheqer edhe gaz se s'kemi pasë rrymë elektrike. Shoktë e mi të klasës e të klasëve tjera shkunë përpara, unë u dufke me prit derisa të hapet dugoja aty në Banjë. E kom pasë niparë pantollë të kanoptë edhe m'u patën çkye mbi gju. Mbeta vetëm kah shkova. Kish pasë ra borë e madhe. Kur jom dalë në afërsi të shpisë time atje, në fshatar i joni, në Ruhani Ramce i kemi thanë, ish dalë me kërkë djalin e vet për me ia çelë rremën për mos me mbetë në borë. Ai kish kalu në tjetër rrugë e fati jem qëllloi unë në qat' Ruhanin e bashkë me to deri te shpija e tina. Tani kur kemi mri te shpija kemi thirrë te shpija ime, s'u konë nja në kilometër me thanë edhe i ka njoftu se jam te ta. Erdh baba tani më murr.

Anita Susuri: Sa vjeçar keni qenë atëherë?

Ajet Duli: Atëherë kom qenë kah dymdhetë vjeçar qashtu.

Anita Susuri: Domethonë, ka qenë rrugë e rrezikshme.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: E qysh ka qenë krejt situata, për shembull, kur jeni rritë, situata me thanë politike? Ka qenë ajo periudha e Rankoviçit, ju keni qenë diku qishtu dhjetë, dymdhetë vjeçar ndoshta. A u vrejtë qajo në rrethin ku keni jetu? Qato presionet politike.

Ajet Duli: Në familje tonë nuk ka pasë, nuk ka pasë. Për arsye se gjyshi edhe vllavi i gjyshit tim, Haliti edhe Halimi Duli mbiemrin, ata kanë qenë mas Luftës të Dytë Botërore në '45-ten s'bashku edhe me disa bashkëfshatarë i kanë marrë partizanët edhe sot e asaj dite ne nuk ju dijmë ku i kanë vorret. A babgjyshi im edhe ai vllavi i babgjyshit Halimi kanë qenë shumë të zotë. Kryesisht partizanët të them në thojza çetnikët e vërtetë na i kanë marrë edhe ju kanë hup edhe edhe gjurmët e gjenazeve.

Anita Susuri: A e dini edhe naj tregim ma shumë, për shembull qysh kanë ardhë m'i marrë apo qysh ka qenë kjo?

Ajet Duli: Po, kur janë ardhë m'i marrë e kanë marrë babën tim se gjyshi s'ka qenë aty. Janë kanë do, ju kemi thonë Limaniovit, Limani po me mbiemrin Baftiu. Aty kanë qenë të vendosur, ai shtabi i partizanëve edhe tashti kanë hi nëpër katun krejt burrat ma të zotë që kanë qenë i kanë mbledhë, po kur janë ardhë te shpija jonë aty s'ka qëllu gjyshi e kanë marrë babën.

Anita Susuri: A u konë i ri?

Ajet Duli: Baba u konë 17-18 vjeçar në atë kohë. Edhe kur i kanë rreshtu për m'i çu për Banjë të Sijarinës, veç prej fshatit Svircë 23 vetë, i kanë lidhë edhe t'u shku... atëherë gjyshja edhe ka insistu te baba, te burri i vet i ka thanë, "Shko se na murrën djalin", edhe u shku. E kanë shti gjyshin aty e kanë lidhë, babën e kanë lshu se ka qenë i ri.

Anita Susuri: Edhe ma nuk u ditë kah janë?

Ajet Duli: Sot e asaj dite nuk e dijmë. Tash se jom anëtar i klubit "Trojet", bile kom qenë dy herë kryetar i kryesisë të klubit. E kemi hulumtue, janë gjetë vendi ku janë eshnat e tyne, po s'po na lejojnë hala me shku m'i marrë ata eshna. Po mujshim diqysh me e ba ni lapidar te Banja e Sijarinës edhe me ba si lapidar edhe m'i shkru emrat e tyne viktimave të cilat kanë ndodhë në atë kohë.

Anita Susuri: Ku është ai vendi ma saktë që kanë qenë? Qaty në Sijarinë dikund?

Ajet Duli: Jo, ata i kanë marrë, i kanë çu në Lebanë prej Medvegje, i kanë çu në Lebanë në kamë. Ni djalë i Halimit, Ramadan e ka pasë emrin edhe ai ka vdekë tash, u shku në Lebanë me çu me kije edhe me kerr diçka ka çu dru, a diçka ka çu atje. Kur ka shku atje ni rrethojë i ka vrejtë ata katunartë edhe babën e vet edhe gjyshin tem, domethënë mixhën e vet. Ky e ka pasë do bukë në ni strajcë edhe ju ka gju qata bukë. “Meniherë”, tha, “kanë nga ata edhe ju kanë marrë s’ju kanë lanë”, tha, “bukën”. Kish pasë thanë Halimi, baba i Danit, “O shkoni te Avdia e flukju Avdisë të Jasharoviçëve”. Kur kthehet ky thotë, “Valla qishtu e pashë”, qishtu edhe më thanë si, “shkoni te Avdia”. Avdia ka qenë ni njeri me autoritet edhe gjatë luftës e ka gjetë ni të plagosun e ka marrë e ka majt në atë kohë. Tani ka pasë nifarë autoriteti. Po kur kanë shku me i thanë, “A po shkon mujsh me i nxjerrë, a diçka?” Ka thanë, “Vallahi s’guxoj, osht’ gjendje e randë edhe ka marrë fund ajo”. Kjo u kanë mas dy-tri dite qishtu.

Anita Susuri: E ju sa keni qenë fëmi, për shembull, a, a jeni, si me thanë...

Ajet Duli: Jo veç edhe diçka dua të ceki. Baba, sidomos, se u konë ditë bajrami kur e kanë marrë atëherë gjyshin. Gjithmonë kur janë konë festat ka qenë gjithmonë i brengosur, gjithmonë i mërzhitur edhe ka vujt shumë. Ni kohë të gjatë tregonte se priste kur do të kthehet, kur do të kthehet, ai s’u kthy kurrë.

Anita Susuri: Si fëmi deshta me thanë, ju a jeni rritë me qito tregime nëpër oda nëpër... tregime të shqiptarëve?

Ajet Duli: Po, po. Gjithmonë nëpër oda, nëpër tubime janë diskutu këto. Po duhet ta tregoj edhe ni rast. Në Banjë të Sijarinës ka qenë ni arsimtar i qujtur Mumin Kastrati. Mumin Kastrati kishte qenë i burgosur politik, i rrethit të Dardanës së Kamenicës atje. Atje s’ka mujtë me u punësue po në Banjë të Sijarinës, meqenëse u konë mungesa e arsimtarëve e kanë marrë e kanë punësu. Në Banjë të Sijarinës ka dhanë... shqip na ka dhanë edhe na ka dhanë histori. Mumin Kastrati ish konë në burg me ni Rrahim Lipovicën, Redenica. Tasht ky kur e ka kry Rrahimi burgun ka dalë në Turqi. Në Turqi atje u martu i ka pasë tre fëmi, po u ngatërru me gru e ka mytë grunë edhe u kthy apet. A prej Jugosllavie ka ikë prej burgut.

Këta janë konë t’u jetu në ni fshat në Marevc. Vllavi i tina Shahin Redenica kur kthehet ky prej frikës se pi bijnë në fije policia e ka marrë ata edhe u ardhë te na, Rrahimi. Nana e ka pasë tezak edhe Rrahimin edhe këtë Shahinin. Kur janë ardhë para mëngjesit, natën, e kanë thirrë. Jemi çue para sabahit edhe janë ardhë janë hi mrena ata. Nana e ka përgatitë do ushqim edhe ju ka kthye me hangër bukë qatëherë natën. Ni krelanë e qitshin atëherë shpejt e shpejt gratë tona haj medet haj. Po më vetë ai Rrahimi tha, “Kush po të jep mësim?” Se kish marrë vesh ai se osht’ ai. Thashë, “Valla, Mumin Kastrati më jep edhe shqip edhe histori”. “A e din ku banon?” “Qysh jo, more. E di”, thashë, “në Banjë të Sijarinës. Ja di edhe banesën”.

I marrë unë ata dy pa u zditë ferku i dritës akoma edhe i çoj te Mumin Kastrati. Kur shkum, ai ish konë fjetun, i kërsohem në dritare dul edhe u mahnit kur na pa. Po u frigose se çka u ba, se siç thojnë mizën mas veshi ai si i burgosun politik. Kur janë hi t'janë kapë me u përçafue Rrahimi edhe ai arsimtari Mumin. Tregonte Mumin Kastrati çfarë torture e çfarë hjekash ka përjetue, saqë... ai ka qenë gati ni metër e 80 i gjatë e i gjanë, "Po në 35 kilogram", tha, "kom ra, edhe pesë kilogram nuk jom konë në gjendje prej tokes me i shkëputë. Qaq shumë që më kanë torturu edhe më kanë mundue". U kanë shumë interesant, se atëherë aty më tha, "S'bon kërkush, inson i gjallë me ditë se janë kanë kta te une se kemi pasoja. Ti s'bon me folë". Kurrë s'kom folë.

Por kur mbajshim orë me ni moment të caktuar, Mumini u dekoncentrojke. Si ish t'u shpjegu *tap* {onomotope} dilke prej temës. Tasht për me e kriju nifarë atmosfere a din, më thirrke mu, "More Ajet Duli, more të vraft qulli. More Ajet Duli, more të vraft qulli" (buzëqeshë). Na nxanësit qeshnim. "Ah po, ku mbetëm, ku mbetëm?" A din, gjithmonë tani na ia rikujtojshim ku kemi mbetë se kishte mbetë me pasoja. Mandej edhe ajo neja aty edhe ai qëndrim edhe ai përshkrim ka lanë mbresa shumë të mdhaja në mua.

Anita Susuri: Po që thatë që keni qenë gjenerata e parë, çfarë mësuesë keni pasë? A keni pasë edhe tjerë për shembull arsimtarë?

Ajet Duli: I kemi pasë tjerë janë konë të komunës të Medvegjës, e kemi pasë edhe ni Hisen Konçeli ka qenë, edhe ai i rrethit të Dardanit, Kamenicës. Tjerë kanë qenë krejt bashkëfshatarë tonë.

Anita Susuri: A kanë qenë mësuesë të ri ata?

Ajet Duli: Valla, kanë qenë të ri edhe e kemi pasë ni msuse ajo është gjallë hala, Havza, msusja Havza, Havzë Ferati-Hajdari. Ka qenë mësuse e mrekullueshme, arsimtare, ne na ka dhanë gjeografi, na ka dhanë në Banjë të Sijarinës aty. Mësuse ka qenë po ka qenë shumë e përkushtuar edhe e pregatitne. E kemi pasë Bafti Krasniqi, i cili ka pasë dhanë kontribut të jashtëzakonshëm për m'u hapë shkolla. Meritat e qitij Bafti Krasniqi, po besa edhe Ramë Xhema u kanë ni veprimtar i cili ka lobu shumë ktu në Kosovë për m'u hapë shkolla shqipe në Medvegjë. E para në Banjë të Sijarinës është hapë, mandej ni vit ma vonë është hapë edhe në Tupallë në gjuhën shqipe.

Anita Susuri: E qysh kanë qenë, për shembull fshatrat e organizume në atë kohë? Çfarë shpija kanë qenë? Qysh ka qenë popullsia? A ka qenë e përzime a?

Ajet Duli: Fshati jonë i ka pasë 500 shtëpi, mbi 500. Krejt kemi qenë shqiptarë. Sijarina ka qenë e përzime me malazezë, serbë edhe shqiptarë. Gurbaci krejt shqiptarë, Kapiti krejt shqiptarë, Llapashtica kryesisht shqiptarë, Topalla shqiptarë. Qito janë konë krejt katune shqiptare, kryesisht të banume me shqiptarë.

Anita Susuri: E rrethi ku keni jetu, a janë konë të ardhun krejt a edhe banorë [të vendit]?

Ajet Duli: Jo, ka pasë venali edhe ka pasë muhaxherë. Në katunin tonë si gjysë për gjysë kemi qenë ashtu, muhaxherë edhe venali.

Anita Susuri: A kanë qenë shpijat si, si...

Ajet Duli: Të shpërndara.

Anita Susuri: Po, po mendoj kështu qysh janë ndërtu shtëpitë, objektet? Çfarë stili kanë qenë për shembull? A kanë qenë të thjeshta?

Ajet Duli: Valla të thjeshta me drunj edhe me pallëzina të mbushuna me lloç në mes edhe të lyera me baltë nga mrena edhe nga jashtë. Mandej nga mrena edhe i kanë gëlqerosë.

Anita Susuri: A kanë qenë shembull shpija të mdhaja apo a kanë pasë ashtu për kafshë, aty me ndjetë kafsha?

Ajet Duli: Po, kemi mbajtë edhe kafshë, po kafshët i kemi majtë nëpër podrume. A naltë, mbi podrum e kemi pasë odën edhe ni dhomë. Te shtëpia kemi pasë shtëpinë ku është gatue edhe kemi pasë ni dhomë ku kemi fjetë. E kemi pasë çarranikun.

Anita Susuri: Çka osht' ajo? (qeshë)

Ajet Duli: Çarranik i kemi thanë aty ku bylmeti ku u mbajtë.

Anita Susuri: E a ka qenë t'u jetu në atë shtëpi veç familja juj e ngushtë, a keni jetu edhe me axhallarë?

Ajet Duli: Une s'e maj men. A e maj mend vetëm si na kemi qenë familja jonë, kemi qenë katër vllazën, dy motra, dy prindtë.

Anita Susuri: A jeni konë ju, cili fëmi me radhë keni qenë?

Ajet Duli: Unë kom qenë i dyti prej djemve. Vllavi i madh Bejta, unë kom qenë i dyti Ajeti, i treti ka qenë Zymeri ka vdekë, Ganiu është i katërti dhe Ramizi i pesti. Jemi gjallë na të katërtit edhe dy motra Fatimja dhe Rrahimja. Rrahimja jeton tash në Suedi edhe ka kriju familje, i ka tre fëmi, i ka martue.

Anita Susuri: Po a ka qenë vështirë, shembull për familjen e juj kur keni vendosë ju me ardhë në Prishtinë në Shkollë Normale kur jeni regjistru, për shembull, nga ana financiare me kalu knej?

Ajet Duli: Unë e kom pasë dajën ktu në Prishtinë, i cili ka dalë para nesh edhe kom banu ni vit te daja, falë m'ka majtë daja qat' vit. Tani vitin tjetër jemi shpërngulë krejt familja kemi ardhë...

Anita Susuri: '69-ën?

Ajet Duli: '69-ën kom dalë unë, në '70-ën qaty në mars kemi dalë me familje. Veç edhe diçka të ceku...

Anita Susuri: Po, po, urdhno.

Ajet Duli: Baba ka qenë shumë i brengosur edhe s'ka pasë qef me e lshu Svircën edhe kur kemi vendosë edhe kemi dalë knena ka qajtë si fëmi. Po mas ni kohe të caktume baba u punësu në Shkollë të Lartë Pedagogjike.

Anita Susuri: A ka qenë si...

Ajet Duli: Punëtor, kurir i shkollës. Më kujtohet e ka pasë kapelën e bardhë edhe aty u dufke me pastrue koridoret edhe nevojtoret. E hjekë kapelën e bardhë edhe e vendosi ni kapelë, beretkë i thojshin, e zezë. Ramiz Kelmendi ka qenë t'u dhanë mësim aty, ky shkrimtari i cili i ka pat' ndihmu shumë babës për m'u punësue. Kur e sheh se e ka hjekë e thrrasin në drejtori atë ditë. "Ramë pse e ke hjekë kapuqin e bardhë?" Baba po thotë, "Ndëgjo drejtor, me kapuq të bardhë nuk hihet me pastrue në nevojtores". Kishin qeshë ata, po.

Anita Susuri: Kur keni ardhë ju në '69-ën në Prishtinë, qysh u konë Prishtina? Në cilën lagje keni banu?

Ajet Duli: Kemi banue ni lagje quhet Rruga e Bledit, Lagjja e Bledit osht' qujtë. Nëpërmes asaj lagje ka qenë kanalizimi. Baltë, kijamet, mos me ta marrë mendja hiç. S'ka pasë ujësjellës, me bunar. Kushtet kanë qenë shumë të vështira.

Anita Susuri: Ka qenë shpi ajo ku ka jetu daja?

Ajet Duli: Po, po. Shpi ka qenë daja ku ka jetue. Tani edhe na jo fort larg prej dajës jemi ardhë e kemi ndërtue ni shtëpi.

Anita Susuri: E dajtë a kanë qenë prej ktu me prejardhje apo janë largu edhe ata?

Ajet Duli: Jo, dajtë i kom pasë Kapit. Janë të njohur kjo familja Kapiti. Ata, ai daja ka dalë prej Tupalle ka dalë në Marevc. Ka jetu dhetë vjet në Marevc e prej Marevcit ka ra ktu në Prishtinë. Sot është t'u jetu në Sofali edhe i ka 300 copa dhi i mbanë (buzëqeshë).

Anita Susuri: Osht' hala.

Ajet Duli: Hala gjallë është, po.

Anita Susuri: E qysh ka qenë Prishtina për juve? A u konë hera e parë që keni udhëtu ndoshta?

Ajet Duli: Hera e parë që kom ardhë në Prishtinë.

Anita Susuri: Qysh ju ka dokë?

Ajet Duli: Ndëgjo, unë e kom ëndërru diqysh Kosovën edhe Prishtinën. Kisha pasë qef me më pat' vetë me qat' andrrën qysh e kom mendue. Qysh e kom mendue, qysh është me pemë, me qershia, me Gërmia e fantazojsha ashtu. Kur jom ardhë e kom pa, e kom pa si nuk osht' kërkund ashtu qysh e kom pasë atë mendim.

Anita Susuri: A ju ka mbetë në mendje, për shembull, ndonjë objekt ose diçka që jeni shku gjithë a keni vizitu?

Ajet Duli: Po mendon ktu a?

Anita Susuri: Në Prishtinë, qat' kohë kur jeni...

Ajet Duli: Na vetëm... u konë edhe tezja ime qitu në Rrugën e Bledit, daja. Na kryesisht mes veti qitu. Baba i ka pasë dajtë në Mahallë të Muhaxherëve edhe ata kanë pasë dalë para nesh edhe u konë Mehmeti i Rrahimit, daja i babës tem. Ata janë Radec, të njohun te na. Edhe ata e kanë lshu Radecin edhe kanë dalë. Nëpër krejt ato fshatrat që janë konë të Medvegjës ka Radec. E edhe ai daja Mehmet i ngrati baba kur ka shku ushtar ka mbetë gjyshja, nana me nja dy fëmi. Ai daja Mehmet gjithmonë u kujdes edhe i ka mbajtë gjallë, se s'ka pasë kush me i ndihmu. A baba ka qenë 24 muj ushtar, ka qenë në Sarajevë.

Anita Susuri: Cilat vite kanë qenë ato?

Ajet Duli: E me vite s...

Anita Susuri: Para Luftës së Dytë a?

Ajet Duli: Jo, mas Luftës së Dytë, mas. Se qatëherë kah 17-18 vjeçar ka qenë baba kur... e tani i ka ardhë koha për me shku ushtar edhe nana ka mbetë vetëm me vllaun e madh edhe gjyshja me dy-tri vajza.

Anita Susuri: A ju tregonte baba për shembull për ndonjë përjetim që ka pasë atje në burg. a qysh ka kalu a?

Ajet Duli: Në burg baba s'ka qenë.

Anita Susuri: Më falni në ushtri.

Ajet Duli: A në ushtri. Interesant ka kalu mirë si ushtar baba. S'ka pasë ndonjë problem po veç u konë si, u konë i brengosur për familje për jetën e tyne. Nana tregonte qaq ka qenë mjerim, e qaq ka qenë vështirë, saqë ni laknur e kemi qit' me dy herë, tri herë me të njejtat petë. Kemi mbledhë hitha, barishta të ndryshme për me qit' edhe me e majt shpirtin gjallë. Se në atë kohë edhe i kanë pasë marrë, u dashtë m'i çue ato edhe kafshë edhe drithnat edhe të gjitha u dashtë m'i dorëzu nëpër kooperativa.

Anita Susuri: Ka qenë atëherë që e ka marrë ni pjesë shteti?

Ajet Duli: Po, qato i ka marrë shteti, po. Edhe ashtu s'kanë pasë edhe ju ka marrë do shteti. Kështu që, gjithmonë kanë qenë nën presion qysh me mbetë gjallë. Luftë për ekzistencë ka qenë.

Pjesa e Dytë

Ajet Duli: Po kthet kur ia kom fillue punës. Në '76-'77 kom qenë arsimtar në shkollën fillore, "Zenel Hajdini", në Topallë edhe kom punu ni vit, tre muj e 25 ditë kom përvojë pune që kom fillu në Topallë.

Anita Susuri: A keni udhëtu vazhdimisht për Topallë prej Prishtinës apo si?

Ajet Duli: Jo, kom banu te dajtë në Topallë aty si i kom pasë. Kom banu te ni hallë edhe te ni dajë. E ndërkohë më kanë thirrë edhe kom shku ushtar. Në '78-ën kom qenë ushtar në Ohër edhe pas gjashtë mujve kom shku në Strumnicë kom qenë me gradë detar. Desetar i thojshin serbisht, shqip detar. E kom qenë në Maqedoni ushtar edhe aty e kom pa çfarë të padrejta edhe çfarë politike anti shqiptare u zhvillojke. Unë atëherë kom qenë 26-27 vjeçar, veç kom qenë i pjekur i kom vrejtë ato dukuri. Por ni gjest sado pak i vogël që bënte ndonjë shqiptar e bojshin, si thonë ni fjalë popullore, mizën bullë.

Në Strumnicë niherë kom qenë ushtar me Astrit Bardhin. Astriti ka qenë magjistër i matematikës. Unë u shoqërojsha atje në Strumnicë. Kom qenë, siç thashë, dhjetar edhe niherë e mora Astritin edhe dola me to në qytet se unë e kom pasë të drejtën me hi edhe me dalë, e kom pasë atë lejen. Po tash kta si gjithmonë dikush e kish lajmërue atë oficerin si unë kom dalë me ni ushtar në qytet. Ma kanë çu policinë ushtarake, më kanë marrë mu edhe Astritin edhe na kanë shti në burg. Për të parën herë në

burg kom qenë në Strumnicë si ushtar. Pse? Pse e ke marrë ushtarin e ke dalë në qytet? Ajo s’kish, po qysh me shpreh atë shovinizmin e vet.

Edhe kishte epror ushtarak si me të vërtetë s’kishin bre qef me na pa me sy edhe me konë sen na zhdukshin. Aty në ‘78-ën si me më lind urrejtja ndaj Jugosllavisë, aty si ushtar i kom pa të padrejtat edhe diskriminimi i skajshëm ndaj shqiptarëve. Masi e kom kry ushtarinë jom kthy në Prishtinë, ka qenë vera, s’kisha çka me bo i kom hyp trenit nëpër Beograd e kom shku në Cyrih. Në Cyrih kur kom shkue ka qenë ditë e premte në mramje. Edhe kur dola në qytet i takova do bashkëfshatarë të mi, një Rrahim Doda edhe ma gjetën ni punë. Kom punu me ni kafe në Birmensdorf, nja katër kilometra prej Cyrihut, nja dy muj ditë.

Ndërkohë kom pasë konkuru në shkollën, “Zenel Hajdini”, në Prishtinë. Më lajmërunë se jom pranu edhe me 1 shtator e kom fillue, ‘78-ën, ia kom fillu mësimin në shkollën “Zenel Hajdini”, në Prishtinë. Keq me folë njeri për vetën po është realitet, kom qenë shumë shumë i përkushtum edhe kom punu jashtëzakonisht shumë me nxansa, sidomos në qat’ klasën ku kom qenë kujdestar. U organizojshim, mësim jashtë orarit matematikë, fizikë, kimi me nxansa. Shfaqje, drama të ndryshme organizojshim me qat’ klasën time.

Bile më kujtohet niherë drejtoi më thirri, “Ajet, çka je kah bon?” “Valla qishtu jemi do aktivitete me nxansa t’u i bo”, “More” tha, “ti cilën landë jep?” “Kimi”, se atëherë në “Zenel Hajdin”, dhasha veç kimi. Njëmbëdhjetë klasë kanë qenë, njëmbëdhjetë klasëve u kom dhonë unë kimi. Kah dy orë në javtë i kemi pasë kimi. Tha, “Çka po mirrësh ti me ata? Gjuhtarët e kanë për detyrë me organizue, jo ti”. Thashë, “Çka prishë punë unë me asi?” “Jo, jo, ti kqyre drejtimin”. I kisha ra në sy a din (qeshë). Në shkollën “Zenel Hajdini”, kanë qenë do arsimtarë, do punëtorë e do arsimtarë të cilët kanë qenë të jashtëzakonshëm. Na veç punojshim edhe komunikojshim mes vete edhe këmbëjshim edhe literaturë.

U konë Xhevdet Sylja i cili edhe ai ka ra në burg. Katër vjet... bile unë e kom zëvendësu në “Zenel Hajdin”. Kur ka ra ai i kom pa marrë ortë e tina me i majt. Punojsha paradite e masdite derisa u pranu ni arsimtar i ri. Mas tina u konë edhe ni Vehbi Bajrami, ka dhanë biologji. Ka pa ra edhe ai në burg. I treti kom qenë unë i shkollës, “Zenel Hajdini”, që jom burgosë, me 18 janar, ‘84.

Anita Susuri: A u konë qikjo koha kur ju keni fillu aktivitetin?

Ajet Duli: Aktivitetin e kom fillu ma herët, organizimin edhe takimet me shokë kanë qenë gjatë viteve ‘80-a e sidomos mas vitit ‘81 u mur përmasa shumë të mdhaja tani kjo lëvizje.

Anita Susuri: Qysh ka fillu për juve për shembull? Kush ka qenë ai që ju ka drejtu apo keni qenë njani prej organizatorëve?

Ajet Duli: Po grupin tonë unë e kom pasë ni Remzi Bunjaku qaty kojshi edhe shok. Ai e ka pasë Kadri, Kadri Manin. Kadri Osmani atëherë u qujke, tani ma vonë Kadri Mani, e ndrroi pak mbiemrin. Ai ka qenë i burgosur politik. Kur vjen te Remziu ky Kadriu, më ka thirrë Remziu edhe jemi shku jemi taku me Kadri Osmanin. Tani me Kadriun ia kemi fillue aktivitetin edhe me Remziun. Kemi pasë literaturë, kemi lexu, e kemi bo nifarë organizimi edhe e kemi marrë për detyrë me bo rekrutimin e idhtarëve të ri në organizatë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë... a ka pasë naj vend ku jeni taku të caktum apo e keni ndryshu apo qysh?

Ajet Duli: Jemi taku edhe nëpër shtëpia tona edhe kemi lanë takime në Taukbashçe ose në Gërmi ose atje te shtëpia ime nalt. U takojshim edhe bisedojshim.

Anita Susuri: Po qysh ka qenë organizimi? A keni pasë ndonjë tekst që keni shkru apo rregulla?

Ajet Duli: Po, kemi pasë. Rregullat i kemi pasë edhe tekstin e kemi pasë edhe betimin. M'u betue para flamurit edhe para fotografive, qishtu.

Anita Susuri: Cilat fotografi për shembull? Skënderbeu a?

Ajet Duli: Po, Skënderbeut. Dikush, dikush të Adem Demaçit, dikush qishtu të ktyne...

Anita Susuri: Që kanë qenë aktiv.

Ajet Duli: Po, që kanë qenë, po aktiv edhe ish të burgosur politik.

Anita Susuri: E këto tekstet, për shembull edhe obligimet, çfarë teksti po mendoj çfarë përmbajtje kanë pasë ma konkrete?

Ajet Duli: Po tashi s'po më kujtohet teksti i betimit, a din? Po u konë se betohem se do të punoj, do t'i përkushtona edhe në qoftëse tradhëtoj gjaki jonë i qoftë falë, qishtu. Më kujtohet ni rast, ai Kadri Osmani kur më ka, kur kom pranue si do të jem anëtar i organizatës më ka thanë, "A e din", tha, "se duhet shtatë herë", tha, "me vdekë e tetë herë", tha, "m'u çue për m'u bo anëtarë", tha, "se po kujton se lehtë është m'u bo", se ai kish përvojën. Thashë, "More tetë herë, tetë herë do të jem", thashë, "pjesëtar edhe do të boj me përkushtim në këtë drejtim".

Anita Susuri: E cilat kanë qenë për shembull kriteret për me qenë pjesë e organizatës? A ju kanë përcjellë?

Ajet Duli: Po, sigurisht. Për shembull, kanë marrë, janë interesue kanë ditë çfarë njeri osht', çka punon, a osht' i përkushtum, qishtu ka qenë.

Anita Susuri: Sa kohë për shembull është vëzhgu ni person para se me u bo pjesë?

Ajet Duli: Po nuk e di tash sa kohë, po kryesore nëpër takime qishtu me njerëz kanë pytë, “Qysh osht? Çfarë sjellje ka? A u konë problematik? A osht’ i moralshëm, a i pa moralshëm?” Sidomos çështjet e moralit i kem pa dhanë shumë rëndësi të madhe. Se e di niherë më ka pat’ vetë për njanin, “Çka osht’ puna e filanit?” Kadriu [më pyti]. Thashë, “Valla, djalë i mirë punëtor e krejt po pak osht’” thashë, “i pamoralshëm”, “A”, tha, “në qoftëse osht’”, tha, “i pamoralshëm s’kemi çka bisedojmë ma shumë”, tha, “se ai”, tha, “kur e tradhëton familjen e vet edhe grunë e vet”, tha, “na tradhëton edhe neve”, qishtu.

Anita Susuri: E këto tekstet, sigurisht kanë pasë përmbajtje për pozitën e shqiptarëve...

Ajet Duli: E kemi pasë gazetën, “Zëri i Kosovës”, “Çlirimi”, edhe njo dy-tri gazeta tjera ilegale të cilat u ardhshin prej jashtit edhe i çkepshim anëtarëve edhe atyne simpatizuesve që i kemi pasë.

Anita Susuri: Prej Shqipnisë kanë ardhë apo prej jashtë diku?

Ajet Duli: Jo prej perëndimit, prej perëndimit.

Anita Susuri: E qysh ka qenë ajo...

Ajet Duli: Prej Zvicrrës.

Anita Susuri: Ai rrjeti, a ka pasë njerëz që janë konë në rrjet?

Ajet Duli: Krejt njerëz në rrjet të cilët i kanë pru, i kanë shpërnda, i kanë lexue, i kanë shpërnda ndërmjet veti.

Anita Susuri: E kush ka qenë për shembull financues që i ka shtypë këto që janë marrë?

Ajet Duli: Nuk e di në perëndim atje kush, po. Amo, këtu për shembull shkrimet kanë shku prej Kosovës ka pasë që kanë çue, i kanë marrë, i kanë botue edhe i kanë shpërnda tani.

Anita Susuri: E në Kosovë kështu shtypja nuk është bo a?

Ajet Duli: Po shtypi në atë kohë ka qenë vetëm “Rilindja” si gazetë.

Anita Susuri: Po mendoj këto tekstet e juja nuk janë shtypë?

Ajet Duli: Ah jo, kanë qenë ilegale ato, se krejt veprimtaria është bo ilegale.

Anita Susuri: A keni pasë ju naj shkrim për shembull? Se më tregutë se me shkrim jeni kështu...

Ajet Duli: Jo s'kom pasë, unë s'kom pasë asni shkrim.

Anita Susuri: E përveç kësaj shpërndarjes së ktyre gazetave, a ka pasë edhe ndonjë aktivitet tjetër?

Ajet Duli: Tregova edhe pare si kjo organizata jonë i ka formue shtabet, shtabet operative edhe na ka caktue secilin. Mue si tregova edhe pare, për të parën herë që ju tregova e kom pasë gradën e kapitenit. Për detyrë e kom pasë me formu grupin e treshit edhe me vazhdue aktivitetin...

Anita Susuri: Juve ju kanë qujtë edhe qysh tregutë si partia e luftës...

Ajet Duli: Po, për qata se i kemi formu qato shtabet operative, shtabet rajonale. Për atë edhe na kanë qujtë si parti e luftës.

Anita Susuri: Ku ishit t'u më tregu për partinë e luftës.

Ajet Duli: Po, parti e luftës është qujtë për shkak se janë formu shtabet për të parën herë edhe është parapa ni organizim ushtarak m'u bo për shkak, kemi qenë të bindur se ndryshe nuk mund të çlirohet Kosova përpos ni organizim ushtarak. E tasht disave na i kanë nda disa grada, kurse Adem Demaçin në atë kohë e kemi pasë shpallë marshall edhe ai në atë kohë ka qenë në burg, po organizata jonë e ka gradu me atë gradën e marshallit.

Anita Susuri: Ju thatë që keni qenë dikund 14 veta në grupe?

Ajet Duli: Po, në grupin tonë në atë kohë mbi njëqind kemi qenë në krejt Prishtinën, po na kanë nda nëpër grupe të ndryshme. Unë në qit' grupin tonë kemi qenë 14 vetë. Kadri Osmani, Enver Topalli, Ramë Buja, Raif Qelaj, Nexhmedin Gërguri, Abdullah Rrustolli, Remzi Bunjaku, Rrahim Rama, Agim Dishit, Ibush Dishit edhe ni Mahmut, Mahmuti mbiemrin e ka pasë, bile osht' caktue ambasador ka qenë në Zvicërr pas luftës në Maqedoni. Mahmut Ibrahimit, qe m'u kujtu qitashti, Mahmut Ibrahimit.

Anita Susuri: E ju tashti, qysh ka qenë partia, me i formu qato shtabe? Qysh u bo organizimi me i formu qato shtabe?

Ajet Duli: Unë kur e kom pasë takimin me kit' Kadri Osmanin, më ka pasë thanë që, "Do ta shtrijmë organizimin në krejtë Kosovën, po edhe jashtë Kosovës". Meqenëse unë isha me prejardhje prej Medvegjës atje, "Atëherë e kemi nevojë edhe atë pjesë ta përfshijmë, të kemi anëtarë të lëvizjes edhe atje". Ma kanë pat' dhanë për detyrë me organizu edhe me gjetë njerëz të komunës së Medvegjës të cilët janë të përkushtum për çështje kombëtare.

Anita Susuri: Ju pyta edhe ma herët, por po ju pys edhe tash për me qenë e dokumentume...

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Thatë që kanë mbetë ni grup i vogël, se ka qenë shumë njerëz që kanë qenë anëtarë...

Ajet Duli: Në Medvegjë atje a?

Anita Susuri: Po, në Medvegjë, në atë pjesën.

Ajet Duli: Po, qato 12-13 katune që janë shqiptarë atje kanë qenë mbi tetë mijë shqiptarë viteve të '80-ta kur kom punu unë aty. Dy klasa kanë qenë të pesta, të gjashta, të shtata, të teta vetëm në Topallë. Po gjithashtu edhe në Banjë të Sijarinës, po në Banjë të Sijarinës ka pasë edhe serbë edhe shqiptarë. Ni klasë ka qenë shqiptare, ni klasë serbe. Po vazhdimisht është rritë numri i nxënësve të shqiptarëve, për arsye se nëpër ato fshatrat atje ku janë konë serbët i kanë shitë [pronat], kryesisht i kanë ble shqiptarët edhe ata [serbët] kanë shku për Nish, për Kragujevc, e për Smederevë poshtë atje.

Po kur lufta në Kosovë ka fillue, janë kthye paramilitarët edhe militarët. Kryesisht janë vendosë rreth kufinit me Kosovë edhe kanë fillu presionin mbi popullatën shqiptare atje. Janë shpërngulë shumica e tyre. Sot gjinden në Fushë Kosovë edhe gjinden në Prishtinë, pak në Kamenicë edhe pak në Gjilan. Vetëm në kohën e fundit, sidomos prej vitit 2015 e keq ka fillue çregjistrimi i, çregjistrimi i popullatës shqiptare. Edhe pse janë aty, ka njerëz që kurrë s'janë dalë, s'janë largu nga fshati, nga Medvegja edhe ata i kanë çlye me ni qëllim të caktum që me zvogëlu numrin e votuesve me rast se Vuçiqi ka thanë, "Nuk ka ma tepër se katër apo pesë përqind shqiptarë në komunën e Medvegjës". A në realitet mbi 35 përqind janë konë popullatë shqiptare në komunë të Medvegjës.

Në vitin 2015 janë konë zgjedhjet me 13 shtator në Medvegjë të jashtëzakonshme edhe ne përmes klubit "Trojeve", ku kom qenë edhe unë anëtar i ktij klubi, kemi bo organizimin edhe bile unë kom qenë iniciator për bashkimin e faktorit partiatik në komunën e Medvegjës. I kom thirrë krejt pjesëtarëve e partive politike që kanë qenë në komunën e Medvegjës, kom bisedu me ta edhe kom insistu ta bojmë ni unifikimi të shqiptarëve të Medvegjës. Edhe pse nuk arritëm me bo unifikimin, megjithatë mbetë organizimi edhe mes tyre tani lindi nifarë gare kush po fiton.

Në vitin 2015 i kemi pasë tetë shqiptarë [kandidatë] komunal në Medvegjë, edhe pse në Mutivotë dul policia edhe gjandarmëria edhe i stopoi votuesit edhe nuk i la për me shku me votue. Janë kanë dhjetë autobusë prej Kosovës të organizum me shku në Topallë e në Medvegjë e në Svirçë e me votu. Po megjithatë t'u lejojshin me shku kem t'u dalë si parti ma, me numër ma të madh në komunën e Medvegjës.

Anita Susuri: Po kthena pak ma mrapa që thatë që keni pasë si për detyrë edhe në Medvegjë me i organizu anëtarë ose me gjetë njerëz...

Ajet Duli: Po, po.

Anita Susuri: A ka qenë, po mendoj, grup i madh i këtyre aktivistave?

Ajet Duli: Por në formim e sipër kom qenë aty edhe osht' duftë me qenë shumë i kujdesshëm, se me punu në ilegalitet edhe mos me u zbulue... se ka mjaftu për shembull ni fjalë dikund me rrjedhë ose me... për m'u zbulue. Mandej tani edhe shërbimi u bë, i ka pasë njerëzit të cilët i infiltrojke në mesin e, e ilegalëve dhe kështu që edhe u zbulojshim.

Anita Susuri: E a ka pasë rast kur personalisht e keni, keni ose keni pa ose keni dëgju që gjendet ni person kështu me thanë shpiun në grupin e juj?

Ajet Duli: Po, në qat' kohë s'e di a ju kujtohet, jo ju jeni të reja. Në '84-tën njani, ni Xhevdet s'po më kujtohet tash mbiemri ka pasë depërtue, është dyshu se është infiltruar edhe Bajram Baftiri ka qenë anëtar i qisaj lëvizjes tonë. Ka shku në shtëpi të tina, Bajrami e ka vra ata, ka ikë. Policia e kanë rrethu Kodrën e Trimave e kanë vra edhe Bajram Baftirin...

Anita Susuri: Në cilin vit u konë kjo?

Ajet Duli: Në '84-tën. Po.

Anita Susuri: A keni pasë ju rregulla, sigurisht keni pasë, qysh m'u rujtë për shembull? Mos me ra në dorë të policisë ose mos me ra në sy.

Ajet Duli: Po, po. Ato çdonjani si ka qenë ato e ka ditë, si dihet me punue, me veprue, po mos me u ekspozu. E unë jom mundue n'temën mos me u ekspozu. Po tjetërkush, dikush, dikund kanë rrjedhë fjalët. Veç osht' me randësi se me 16 janar [1984] ka ra Rrahim Rama në burg, me 17 janar ka ra Remzi Bunjaku, me 18 janar kom ra unë. Te unë osht' ndërpre.

Anita Susuri: A po thoni që kanë folë për shembull ata?

Ajet Duli: Eh po, *jaa* {onomotope} s'muj thom po qysh anej knej nuk e di. Ama, e di për veti si shumë kanë bo presion tani për me i qit unë...

Anita Susuri: Po ata tjetër.

Ajet Duli: Rregullin e treshit si ka qenë, se në bazë të rregullit në bazë të treshit kemi punu. Secili m'i gjetë dy, tani ai tjetri, ata me i gjetë kah dy edhe kështu m'u rritë numri.

Anita Susuri: E ju për shembull nuk e keni ditë kush ka qenë ai anëtari tjetër?

Ajet Duli: Jo, jo... veç... për shembull me Kadri Osmanin, me Remzi Bunjakun i kemi pasë takimet. Tani me e rritë numrin. Ka pasë edhe shumë, si shumë vetve ju kom thanë se ma së pari ju dhashim qato gazetatat për me hi në bisedë, për me bisedue, për me tregue, për me pa qëndrimin edhe ajo ishte si fillim i punës tonë.

Anita Susuri: E pastaj qysh ka vazhdu?

Ajet Duli: Po vazhdoi me zbulimin tonë edhe ramje në burg tani. U zbulum, ramë në burg. Na dënunë.

Anita Susuri: Fillimisht po du te '81-ta po du pak m'u nalë...

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Te demonstrata se është me rëndësi...

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Ju, nuk e di a keni qenë ndoshta në rrjedha që kanë me ndodhë demonstratat, a keni dëgju po qysh?

Ajet Duli: Dëgjo, në demonstrata kemi marrë pjesë kështu bashkë me vllazërit edhe me motra. Me njanën se njanën jo, veç me motër. Ajo ka qenë në Fakultet Ekonomik edhe krejt kemi marrë pjesë. Më kujtohet ni demonstratë, e kanë pasë nuanë vllaun tim Ramizin edhe djalin e vllaut tim Rexhepin. I çojnë në burg ku osht' 92-shi, ku osht' policia kryesore aty.

Anita Susuri: Po.

Ajet Duli: I çojnë në burg. Po për atë kohë ka qenë miku jem Bajram Tmava, ka qenë drejtor i Policisë së Kosovës në atë kohë. Gjatë marrjes në pyetje atje edhe kur i sheh, i sheh vllaun tem edhe atë djalin e vllaut edhe kadal i përcjellë, "Ikni edhe mos u gjindni në kësi punë", po. E pjesëmarrës të demonstratave gjithmonë kanë qenë këto shumë masive. Pakënaqësia e popullit u konë shumë e madhe. Po edhe kështu kanë qenë dy tabore të them. Disa që kanë qenë të kënaqun me atë pushtet, i kanë pasë do privilegje, kanë fitu do poste, do anej knej. Po masa e gjerë kryesisht ka qenë e pakënaqur. Ju kanë bashkangjitë.

Anita Susuri: A ju kujtohet juve për shembull, sigurisht ju kujtohet edhe detajet ose çka keni pa ju? Çfarë dhune ka qenë?

Ajet Duli: Po qysh s'na kujtohen ato, qysh jo. Po dhuna ka qenë sidomos gazi lotsjellës ka qenë shumë i fortë edhe kur u hudh, kur na hudhshin ata, se masa qaq e madhe saqë u dashke me kcy edhe njani mbi tjetrin kalojshim duke ikë se na u nxike fryma, frymëmarrja.

Anita Susuri: A ka pasë për shembull që dikond e kanë rreh aty ose e kanë vra?

Ajet Duli: Me vra s'kom pa, po me rreh ajo kuptohet. Çdo demonstratë u përcjellë me lotsjellës, me rrahje, me, po...

Anita Susuri: E qysh ka qenë atëherë kështu ma atmosfera në qytet po mendoj? Ka qenë e acarume po supozoj.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Po qysh kanë qenë rrethanat për shembull? A ka ndodhë edhe ndonji shkatërrim i objekteve në qytet apo ka qenë vetëm policia edhe popullësia në konflikt?

Ajet Duli: Po kryesisht policia edhe popuata gjegjësisht demonstruesit, po. Nuk ka pasë fort shkatërrime në... gjatë demonstratave. Kryesisht kanë qenë paqësore, po tani ka fundi gjithmonë u shndërrojshin në demonstrata të dhunshme. Për arsye se policia ndërhyke edhe i shpërndante demonstruesit me dhunë.

Anita Susuri: Pas ktyne demonstratave ka ndodhë edhe si me thanë, ni diferencim. Janë largu prej punës shumë njerëz që kanë qenë...

Ajet Duli: A prej '81-shit ka fillue diferencimi. Diferencimi u bo në çdo organizatë edhe në çdo shkollë e në çdo... sidomos nishan [në shënjestër] kanë qenë institucionet edukative-arsimore, sidomos Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë e njerëz të cilët sado kudo kanë qenë kombëtarisht të përcaktuar. U bo ni presion edhe ni diferencim i pa parë.

Anita Susuri: Juve s'ju ka ndodhë?

Ajet Duli: Mue jo. Po ka pasë edhe në shkollën tonë aty në "Zenel Hajdin". Janë konë pasë ardhë prej Komiteti për me bo diferencimin, po janë, veç janë cekë disa emra. Kështu që nuk ka pasë...

Anita Susuri: Ju sigurisht edhe nuk jeni mundu që mos m'u shfaqë shumë e mos me ra shumë në sy për shkak të aktivitetit.

Ajet Duli: Është e vërtetë që unë kom qenë ndoshta shumë i mbyllur. Kurrë niherë s’jom ekspozu. Me nxansa kom punu jashtëzakonisht shumë edhe më kujtohet si gjithmonë kom insistu te gjenerata masi ta kryni klasën e tetë me shku m’u regjistru në Armatën Jugosllave. Për arsye se, aty ishin shkollu edhe ata herdo kurdo që kemi pasë raste për shembull se e kanë kry shkollat ushtarake edhe ju kanë bashkangjitë tani UÇK-së.

Anita Susuri: Kanë marrë ekspertizë qaty...

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Edhe e kanë shfrytëzu.

Ajet Duli: Është një Bilall Syla, vendas i jemi i Gërbacit atje ka qenë nxanës i shkollës, “Zenel Hajdini”, jo që i kom dhanë mësim, po ai Xhevdet Syla i ka pa dhanë mësim, e ka pasë nxanës. Ai u konë pasë shku në shkollën ushtarake, ka kry shkollën ushtarake edhe ka qenë organizator i operacionit “Shigjeta”, edhe ka pasë edhe shumë të tjerë. Zymer Halimi edhe ni vendas i jemi edhe ai ka qenë ushtarak. Ka qenë në zonën operative të Shalës, ku ka qenë komandant i ni brigade a qashtu diçka.

Anita Susuri: Ju më thatë që kur jeni burgosë keni qenë i katërti a i pesti me radhë prej njerëzve, grupit.

Ajet Duli: I treti.

Anita Susuri: I treti.

Ajet Duli: Po. I treti me radhë.

Anita Susuri: A keni naj ide për shembull qysh kanë arritë ata me ju zbulu juve? A keni ndonjë hamendësim?

Ajet Duli: Po, sigurisht i kanë përcjellë këta Kadriun edhe çikën e Kadriut ku po shkojnë edhe me ka po kontaktojnë. Më kujtohet niherë u ardhë çika e Kadriut edhe unë kom dalë prej shtëpisë kom dalë në rrugë. Kur jom dalë qe policia. M’u kanë drejtu, “Ku ke ni ndeshje qitu? Ku ke ni ndeshje?” Nuk ke ni ndeshje hiç. Po edhe njo, dhjetë ditë qashtu pa ra në burg, po domethonë masi janë vra Rexhep Mala e Nuhi Berisha me 11 janar [1984]. Atëherë ka fillu edhe vëzhgimi edhe përcjellja e neve si kanë pasë, sigurisht po mendoj se kanë pasë t’dhana se po kontaktojmë diçka. Aty ‘84-ten ka qenë borë e madhe, ka qenë si acar qato ditë. Vazhdimisht njerëz të maskuar, të mbshtjellur lëvizishin nëpër rrugë aty kah shtëpia ime. Më kujtohet niherë bile baba më tha, “Çka dreqi bre janë qita qishtu të pshtjellun? Çka u bo?” Thashë, “Babë”, thashë, “mos u merr me ta. Mos u merr”, thashë, “se s’bon m’u marrë me ta”.

Anita Susuri: Edhe familja sigurisht e ka ditë se...

Ajet Duli: Jo, s'e ka ditë. Shoqja jeme nuk e ka ditë derisa jom burgosë, se jemi rujtë edhe prej familjes që mos m'i qit' në pozitë të keqe. Se për shembull të tregova vllavi i shoqes ka qenë në polici i cili ka qenë drejtor i Policisë së Kosovës në atë kohë. Për çashtje të sigurisë ka qenë Rrahman Morina, Bajram Tmava, për çashtje publike të Kosovës.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Ku keni qenë ju kur ju kanë arrestu?

Ajet Duli: Unë në shtëpi kom qenë. Kanë ardhë me supozimin se vetëm ni deklaratë me dhanë edhe s'kemi punë ma shumë. Por më kanë marrë masdite me 18 janar [1984], më kanë dërgue në stacion të policisë aty edhe prej asaj dite kom qenë në Burg të Prishtinës deri me 12 shkurt në Prishtinë. Mandej më kanë çu në Mitrovicë.

Anita Susuri: E paraprakisht kur kanë ardhë qat' ditë a ju kanë kontrollu shpinë për shembull?

Ajet Duli: Po, po. Ma së pari më kanë marrë mu, po ndërkohë ekipi tjetër ka shku edhe e ka bo kontrollimin e shtëpisë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë reagimi i familjes?

Ajet Duli: Po familja ka qenë e hutume për arsye se...

Anita Susuri: S'e kanë pritë.

Ajet Duli: S'e kanë pritë për arsye se unë s'kom bisedu kurrë niherë me ta se jom i organizum ose do të bëjë qita ose qishtu. Kom pasë parasysh edhe atë se s'kom dashtë me rreziku atë mikun i cili ka qenë në funksione atje. Më kujtohet niherë me Kadri Osmanin thashë, "Bre mikun e kom aty", thashë, "e po më vjen keq anej-knej", tha, "O Ajet", tha, "ai punën e vet, na punën tonë" (qeshë). Nuk e kanë pritë bash mirë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë qajo biseda e parë në polici?

Ajet Duli: Në polici a? Biseda e parë ka qenë pse jom hi ma së pari, pse jom bo anëtar, me kë, qysh? Qashtu ka fillu edhe natën e parë masi, se po du me kallxu qita si të pata thanë në fillim. Natën e parë kur më kanë marrë më kanë çu aty. Veç pat' ra muzgu i parë. Janë ardhë. Ni kohë kom nejt vetëm,

ndërkohë kanë ardhë dy punëtorë të Sigurimit Shtetëror, Muharrem Bekteshi edhe Januz Loshi. Janë prezentue edhe më kanë tregu se janë prej Mitrovicës. Me mu kanë punu kta të Mitrovicës për shkak të Bajramit se janë tutë se mos po kanë ndonjë lidhje ktu e m'i kanë caktu dy prej Mitrovicës edhe dy prej Pejës. Januz Llonçari edhe Demë Muja kanë qenë prej Pejës. Kurse kta dy kanë qenë të Mitrovicës, të Sigurimit Shtetnor.

Qat' natën e parë masi janë ardhë, janë ulë aty e kanë thirrë për me ju sjellë diçka me pi. Ni kamariera ka qenë e kanë thirrë. Ka ardhë ajo kamarierja aty, ata kanë porositë. Më kanë lutë mu, "Çka po don ti me pi?" "S'po du, s'po du". "Jo, jo, ktu s'bon. Krejt po pijmë edhe ti ki me pi", me dhunë. "Hajt bre", thashë, "ni çaj pra". E kanë pru ato edhe kom fillu me pi çajin. T'u e pi çajin, t'u m'u nxe trupi. E pashë se nuk osht' diçka në rregull. Ndërkohë e kom hupë vetëdijen. U konë ni tavolinë e madhe e gjatë edhe jom konë ato karrikat. Nuk e di si unë kom ra mbi qat' tavolinën. Jom përkulë edhe kom ra. Po nuk e di sa kohë kom nejtë në qat' gjendje.

Muharrem Bekteshi e kom pa kur, s'e kom pa, por e ka nxjerrë ai... e ka pasë a s'po di tash qysh e ka pasë atë shufrën e gomës, pendrekin si i kanë thanë. Pranë meje aty i ka sjellë tavolinës me shufër të gomës. Ka kërситë ajo edhe unë qysh kom qenë mbi ata më ka dalë ajo kllape edhe i kom dhanë zor edhe jom çu në kamë. M'u doke si qitu {bën me shenjë tek koka lartë} m'u ka birue koka edhe avull edhe isha ndjersitë. Isha bo ujë, ujë isha bo krejt. Kom thanë, "Zoti ju vraftë, çka më keni ba?" Tha, "Jo", tha, "ti qitash", tha, "ki me knue si bylbyl", tha, "ki me kallxu ku je kanë, çka ke ba, qysh je organizue me rrxu pushtetin tonë". Ndërkohë janë ardhë, u ardhë ni gardian edhe më ka marrë më ka çu në qeli.

Kur jom çu të nesërmit në mëngjes, kom qenë njeri ma i dëshpëruar në jetën time. Por gjatë natës kom bo qasi gjumi, saqë kurrë në jetën time s'kom bo asi gjumë të ranë. Kur jom çu të nesërit në mëngjes o më shkojshin lotë teposhtë e qitu m'u përpjekshin {bën me shenjë tek mjekrra} edhe pikshin lotë. Qaq si kom qenë i emocionuar. Më kanë marrë të nesërit në mëngjes më kanë çu edhe kanë fillu me më rreh. Masi ja kanë nisë me më rreh tani ma gati s'kom folë, po rregullisht sa kom qenë aty nën hetime çdo ditë kah dy herë, tri herë... natën ma kur na marrshin, gjithë natën t'u na rreh.

Anita Susuri: A ju rrehshin me ato shufrat?

Ajet Duli: Me shufra.

Anita Susuri: Për me folë diçka.

Ajet Duli: Po, për me kallxu. Më kujtohet se e kom pasë për detyrë, ma ka pa lypë ai Kadri Osmani ni pasaportë me siguru edhe kom pasë shku në Topallë atje te ni dajë deshta. Niherë deshta me ia vjedhë, me ia marrë pasaportën mos me i tregu, po apet s'mujta. E i thashë atij dajës, i thashë, "S'ka bre çka të vynë", thashë, "a po ma jep qit pasaportë se po më vynte diçka". Po ndërkohë e kishin pasë marrë vesh punën e pasaportit. E për pasaportë s'më vetshin niherë hiç, deri në fund. U konë ai Demë Muja, ka

qenë i Pejës dikund a Istogit, nuk e di. Ai ka qenë xhelat. Xhelat ka qenë, mytë na ka t'u na rreh. Durve, kamve, durve, kamve. Qitu poshtë krejt vred janë konë. U konë ni i Sigurimit Shtetnor, ni vendas i jemi, Xhafer Beshi. Erdh niherë aty. E kish marrë vesh si jom unë i Svirçës atje. Tha, "Qiti durtë". Çka me kqyrë, nime krejt asi... tha, "More", tha, "te koka bo sikur me kanë bojaxhi", tha, "a je kanë najherë", tha, "në Medvegjë", tha, "te bojaxhitë, t'u paskan bo durtë", bojke hajgare.

Anita Susuri: E sa kohë keni qenë nën hetime?

Ajet Duli: Po nën hetime qitu sa kom qenë në Prishtinë tani edhe në Mitrovicë. Veç nja ni muj ditë më kanë, veç qajo ka qenë intenzive. Gati ni muj ditë, për çdo ditë t'u na malltretue, t'u na rreh. Vetëm ni dukuri e kom vrejte kur isha vetëm, për shembull, me Januz Loshin se osht' interesant ky Januz Loshi tani osht' edhe vet i burgosun politik mas, ma vonë u konë pa ra edhe vet në burg. Kur ish vetëm, ma nuk përdorshin dhunë. Dhuna sidomos kur u bojshin si kallabllak ose kur ardhke ndonjë serb aty, u ulke qatëherë dojshin shpirtin me ta nxjerrë.

Anita Susuri: A kanë qenë kryesisht shqiptarë?

Ajet Duli: Kryesisht shqiptarë, kryesisht shqiptarë.

Anita Susuri: E ky Burgu i Prishtinës çfarë burgu ka qenë për shembull? Qelitë qysh kanë qenë? A kanë qenë shumë njerëz në qeli?

Ajet Duli: Po, qysh jo. Plot aty kah shtatë-tetë vetë. Gjatësia sa ka qenë, katër metra, dy metra e diçka me tri metra e gjonë. Ka shtatë-tetë vetë. Po ma mjerim ka qenë në Mitrovicë. Për arsye se në qat' kohë u patën burgosë do si i kanë pa keqpërdorë në Trepçë atje do kristale, do ari e argjend i kanë pa vjedhë e tani u shtu numri i tyne. Bojke vakti 13 vetë me ni qeli qaty, dy metra e 40-50. Tre shtretër njëra anë, tre tjetra anë, do fjetshim në do dyshek poshtë. Merre me mend ti, kur u dhezshin aty dhetë cigare. E u konë ni vrimë, ni dritare e vogël aty, e pashe si për kaftorri t'u shku timi. Unë kom qenë gjithmonë, s'e kom pi kurrë niherë duhanin edhe jom konë si alergjik prej duhanit. Gjithmonë m'u dufke m'u shtri për toke me ra për shkak timit si e pijshin.

Anita Susuri: E qysh kanë qenë për shembull kushtet e ushqimit, për shembull banjos?

Ajet Duli: Ushqimi, ushqimi, ushqimi shumë i dobët edhe edhe higjiena me teglla u dufke me kry nevojën. 24 orë dy herë na qitshin në banjo. Kushte jashtëzakonisht të vështira. Në Mitrovicë u konë ni dukuri, për shembull çdo dy javë ditë i ndrojshim ato çarçafat edhe i shkunshim. Kaniherë i shkunshim, kaniherë s'na lashin as m'i shkunë batanijet. Jo krejt gardianët, po disa që janë konë të ngarkuar me shovinizëm. Kur hishim m'u pastrue, hala mirë pa u shkumue e t'na lshojke ujtë e ftoftë e t'ikshim krejt anash. Hishim aty me na lshu, na lshojke ujtë e nxehtë, gati valë, na përvlojke. E ikë.

Kështu që, herë gjysë të lamë, herë pa la, herë të lamë. E kur ishin gardianët që sado kudo kishin sjellje korrekte anej knena u lajshim edhe s'bonin asi veprime qysh i bojshin ata.

Anita Susuri: Sa shpesh ju kanë çu m'u pastru?

Ajet Duli: Po në javtë niherë, në javtë niherë.

Anita Susuri: Krejt grup qashtu?

Ajet Duli: Krejt grup.

Anita Susuri: E a keni pasë të drejtë, për shembull për vizita në atë kohë sa kanë qenë hetimet?

Ajet Duli: Vizitat kanë qenë familjartë e ngushtë.

Anita Susuri: A keni mujtë me folë aty diçka ma apo?

Ajet Duli: Jo, jo. Gjithmonë me mbikqyrje të ni Sigurimit Shtetnor.

Anita Susuri: Për shembull, familja kur ka ardhë fillimisht me ju pa, çka ju kanë thanë për shembull? Se p'e di që nuk kanë ditë.

Ajet Duli: Po shumë shkurt aty, "Qysh je? A je mirë? A ki ndonjë problem? A je mirë?" Qito. Po na vetshim për familje, "Qysh janë a janë krejt shnosh, qysh është ai, qysh është ky". Po, shumë shpejt ato. Për katër-pesë minuta...

Anita Susuri: Nuk ju lejshin ma shumë.

Ajet Duli: S'na lashin ma shumë hiç. Po.

Anita Susuri: Po më intereson tash qit ni muj a sa thatë që keni qenë nën hetime, keni pasë dhunë vazhdimisht fizike. Masi keni dalë në gjykatë, po më intereson sa ka qenë grupi? Në fakt...

Ajet Duli: 14, po.

Anita Susuri: Me më tregu pak për qita, për aktakuzën, për, qysh ka qenë?

Ajet Duli: Po aktakuza ka qenë bashkim për veprimtari armiqësore. Qashtu u qujtë. E lidhnin me Nenin 144 për rrënimin e Jugosllavisë. Qashtu ka qenë ajo. Për të gjithë ka qenë gati e njejta, thu ti se i njejtë grup ka qenë. Se i kanë marrë prej njanit i kanë bartë aty edhe kryesisht kanë qenë formulime qato për

rrënimin e Jugosllavisë, e për shkatërrimin e “Vllaznim-Bashkimit”, e për rrënimin e bazës ekonomike të Jugosllavisë. Kryesisht qato kanë qenë ato aktakuzat bazë.

Anita Susuri: Juve ju dënujë sa vjet?

Ajet Duli: Shtatë vite. Shtatë vite s’i kom majtë, [por] gjashtë vite e tre muj e pesë ditë. Atëherë e kom pasë, jom konë i martum e kom pasë ni vajzë. Vajza Vjosa ka qenë 14 mujsh kur kom ra në burg, kur jom dalë prej burgut ka qenë në klasën e dytë në filllore. Gjashtë vjet, tre muj e pesë ditë pa asniherë pa shku në shtëpi, gjithmonë veç në burg.

Anita Susuri: A ju ka vizitu vajza për shembull? A ka pasë...

Ajet Duli: Po, vajza ka qenë niherë në Mitrovicë edhe s’e kanë lanë me hi hiç. Në Gjyrakovc e kom pa prej dritarës, pi dritare naltë, ajo u konë mrapa atje. E kom pa. E masi jom shku në Lepogllavë, atëherë në Lepogllavë janë ardhë niherë e kom taku vajzën.

Anita Susuri: E juve kur ju kanë dhonë dënimin, 14 persona që keni qenë. Cili ka qenë dënimi ma i madh?

Ajet Duli: 15 vjeçar.

Anita Susuri: 15 vjet.

Ajet Duli: Po. 15 vjet Kadri Osmani.

Anita Susuri: Kadri Osmani. Prej aty juve ju kanë dërgu në?

Ajet Duli: Prej Prishtine në Mitrovicë.

Anita Susuri: Në Mitrovicë. Kur ju kanë dënu keni qenë në Mitrovicë?

Ajet Duli: Po kur jemi dënu na kanë pru prej Mitrovicës gjithmonë ktu. E prej Mitrovicës kom qenë në Gjyrakovc kom nejtë nja pesë muj ditë. Mirëpo, kushtet edhe ushqimi edhe të gjitha aty në Gjyrakovc kanë qenë jashtëzakonisht të mira, në krahasim me burgjet hetuese. E prej Gjyrakovci nantë muj ditë tani më kanë kthy prapë në Burgun Hetues të Gjilanit. Prej Gjilanit na kanë çue për Zagreb. Në grup prej Gjilanit kemi qenë unë, Xhabir Morina edhe Fehmi Lladrovci. Na kanë lidhë me do...

Anita Susuri: Pranga?

Ajet Duli: Pranga jo, po zinxhirë. Me zinxhirë po. Na kanë pru këtu në Prishtinë, prej Prishtine na kanë çu për Zagreb. Në Zagreb kemi bujtë dy netë, tri edhe tani prej Zagrebi na kanë çu në Lepogllavë. Në Lepogllavë kom nejtë njëmbëdhjetë muj. Prej Lepogllave në Gospiç ni muj ditë. Prej Gospiçi në Staragradishtë. Nja dy vite e gjysë në Staragradishtë. Aty kemi nejtë me Adem Demaçin edhe shumë tjerë të burgosur politikë. Mbi 50 kemi qenë të burgosur politikë. Aty...

Anita Susuri: Edhe prej atje jeni liru?

Ajet Duli: Sa kemi qenë aty në vitin '90-të qatëherë kur pak para se me na lshue nja dy ditë, dy netë e tri ditë na kanë çue në Sllovensko të Pozhegut mu, Bacën Adem edhe nja katër tjerë. Prej aty jemi, na kanë lirue edhe jemi kthye në shtëpi.

Anita Susuri: Po du pak m'u kthy te kto burgjet që i përmendët ma herët, Gjyrakocin për shembull. Ku për shembull kur ju kanë ndrru burgjet...

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: A ju kanë...

Ajet Duli: Me përcjellje.

Anita Susuri: A ju kanë njoftu paraprakisht që, a veç ju kanë marrë?

Ajet Duli: Veç na kanë marrë edhe me përcjellje përpara dhe përmbropa edhe na kanë çue nëpër burgje.

Anita Susuri: E Burgu i Gjyrakocit thatë që ka qenë me kushte ma të mira...

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Osht' ni burg që ka funksionu edhe para Luftës së Dytë Botërore, qysh ju kujtohet juve ai burg?

Ajet Duli: Po sado kudo, atje kemi qenë si gjysë të shlrë, nuk kemi qenë të mbyllur nëpër dhoma për mos me mujtë me dalë hiç. Por tërë ditën nejsim jashtë në kopsht edhe aty bisedojshim na mes veti, debatojshim, lexojshim libra sa mujshim. Ajri ka qenë shumë i mirë aty në Gjyrakoc. Uji ka qenë, uji ka qenë shumë i mirë se e bonte tretjen e ushqimit edhe shpejt e shpejt u untojshin. Se po get se ka pasë gur gëlqeror ata pak edhe e bonte tretjen e ushqimit. Kështu që, qysh kemi shku edhe qysh ardhshin aty prej burgut hetues të burgosurit politikë të zbehtë, e veç u shifke në ftyrë njeri a din i rraskapitur kështu edhe i mundum, aty meniherë fillojshim edhe m'u ringjallë edhe niherë.

Anita Susuri: A ka qenë si me tela i lidhur ai kopshti a ka qenë...

Ajet Duli: Jo, kopshti mrena ka qenë veç në tona antë kanë qenë muret si u konë e pamundur për me ikë, me i tejkalu. Se janë konë edhe të naltë edhe janë konë pengesat edhe vëzhgimi nonstop.

Anita Susuri: A ka qenë burg i madh ai?

Ajet Duli: Ka qenë, goxha i madh ka qenë. Po dhomat kanë qenë ma të mëdhaja, kushtet higjienike kanë qenë ma të mira në krahasim me burgjet hetuese. Aty ka qenë shumë ma mirë.

Anita Susuri: Po më intereson edhe në Gjyrakoc qysh, qysh ka qenë qikjo që po thoni që ju keni dalë në oborr, në kopsht kur keni dashtë. A nuk ka qenë diçka e ndalume apo...

Ajet Duli: Ma shumë ka qenë e ndalume me nejt mrena, se i lajshim dritaret, i hapshim dalshim në mëngjes honkshim aty edhe tani derisa ardhke dreka. Tani ardhke mramja veç shkojshim për me fjetë.

Anita Susuri: A ka pasë salla për shembull të ushqimit apo salla...

Ajet Duli: Po, po, të ushqimit kanë qenë sallat edhe ata kryesisht kanë qenë të burgosur si e kanë përgatitë ushqimin.

Anita Susuri: Të burgosurit.

Ajet Duli: Po. Bile, më kujtohet ni vendas i imi ka qenë kuzhinier aty. Ai ka qenë për vrasje, tani e kishin bo kuzhinier. Ai e përgatitke ushqimin.

Anita Susuri: A ka pasë secili i burgosun detyra të ndame si punë apo?

Ajet Duli: Jo, na çka kemi qenë politikë s'kanë ndërhy me ne, s'kanë deshtë me hi në biseda as kështu. E kanë pasë nifarë qëndrimi gardianët.

Anita Susuri: S'ju kanë ngucë as?

Ajet Duli: Po s'na kanë ngucë as... rrallë ndonjiherë që ka ndodhë ndonjë aksident, se kështu jo.

Anita Susuri: Sa thatë që keni qëndru në Gjyrakoc?

Ajet Duli: Pesë muj ditë.

Anita Susuri: Pesë muj ditë.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Edhe gjatë kësaj kohe keni pasë sigurisht vizita, ju kanë sjellë libra sigurisht diçka me lexu që thatë apo i keni pasë aty?

Ajet Duli: Po libra ka pasë edhe nëpër biblioteka. Interesant çdo burg i ka pasë bibliotekat edhe vazhdimisht u furnizojshim me libra. Kryesisht kanë qenë libra të kohës edhe të vjetra ka pasë edhe të reja, po ne sidomos ma së shumti kemi lexue librat e Rexhep Qosjes.

Anita Susuri: Biblioteka e Gjyrakocit a u konë e madhe apo qysh? A keni mujtë me marrë librat cilat keni dashtë apo janë konë të censurume?

Ajet Duli: Jo, librat na prushin edhe nga shtëpia, po. Na prushin edhe nga shtëpia edhe tani i këmbeshim mes veti.

Anita Susuri: A ka pasë naj libër të ndalum për shembull?

Ajet Duli: Ato të ndalumet s'i kanë pru, as s'i kanë lonë me hi. Kryesisht librat të cilat, kryesisht kanë pasë ni tematikë, jo çashtje nacionale apo diçka, po ma shumë libra, për shembull për Aristotelin e për Sokratin e qito. Ka pasë për Bakariqin¹ e për Titon, qito libra. Ato na s'i lexojshim, kryesisht na lexojshim libra të cilat neve na interesonte ma fort. Romane për shembull kemi lexu.

Anita Susuri: A ka pasë për shembull, se kom dëgju edhe për shembull filma që kanë dhanë në burgje. Ka qenë si aktivitet me pa ni film ose...

Ajet Duli: Jo, te na jo.

Anita Susuri: Te ju s'ka ndodhë.

Ajet Duli: Jo.

Anita Susuri: E mas Gjyrakocit ju jeni vendosë në...

Ajet Duli: Gjilan.

Anita Susuri: Gjilan.

¹ Vladimir Bakarić (Vlladimir Bakariq; 8 mars 1912 – 16 janar 1983) ishte një revolucionar dhe politikan komunist jugosllav dhe kroat.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë tash Gjilani? A ju ka ardhë keq që jeni largu prej Gjyrakocit?

Ajet Duli: Me ta thanë të drejtën ma së miri ish kanë në Gjyrakoc. Në Gjilan burg hetues, apet filloi ajo si prej fillimi, përpos dhunën që s'e kemi pasë. Se kishin përfundu veç hetimet për ne. Po apet në burgje të mbyllura, gjithë ditën t'u nejtë mrena. Veç kur na çojshin për pastrim, dy herë 24 orë edhe mrena.

Anita Susuri: Pastaj Zagrebi, pak ma larg.

Ajet Duli: Po, tasht u bo problem shumë për familje.

Anita Susuri: Po.

Ajet Duli: Çfarë rruge e gjatë edhe kur ardhshin gjithmonë nëpër trene, nëpër se pat' fillu ajo urrejtja ndaj shqiptarëve edhe t'u i malltretu edhe familjet e tu, t'u i shajtë. S'kanë guxu as me folë fëmija si i ndëgjojshin si po flasin shqip, "Na shajshin", tha, "na piskatshin". Kështu që, u kanë situatë shumë e randë, shumë e padëshirueshme.

Anita Susuri: Sa shpesh, për shembull ju ka vizitu atje familja?

Ajet Duli: Po jo, pak. Dy-tre muj ditë niherë.

Anita Susuri: E kur kështu pozita e familjes qysh ka qenë? Se ju tash si kreri i familjes, si financuesi e ai që e ka mbajtur familjen nuk ka qenë mo. Qysh ka qenë tani gjendja ekonomike e familjes?

Ajet Duli: E ndëgjo. Ajo shumë i preokupojke këta të Sigurimit Shtetnor, për arsye se unë nime nuk i kom pasë kushtet e vështira në atë kohë siç... se vëllau dhe motra kanë qenë në Fakultetin Ekonomik. Unë pata krye Shkollën e Lartë Pedagogjike, baba punonte në shkollë si kurir. Vllavi i madh ka punu nifare posti krahinor i arsimit ka qenë...

Anita Susuri: A ju keni qenë atëherë hala në bashkësi me vllazën?

Ajet Duli: Po, me vllazën. Vllavi i madh veç u konë pa nda në qat' kohë. Pa ra unë në burg ka pa dalë në shtëpi të vete. E ka pasë ndërtu edhe ka pa dalë në shtëpi të vet. Po gjithë ishim edhe të ri edhe të shkollum tash familja edhe kushtet goxha të mira. Se unë isha i martum, shoqja më punonte mësuse, unë arsimtar, dy rroga me i pasë edhe baba ni rrogë tjetër. Plus e kemi pasë mbajshim lopë atëherë. Këtu i kemi pasë kah dy-tri lopë. Kishim qumështin, kishim bylmetin tonë. Bile edhe shitshim ka pak

tamël, qumësht. Jo naj viç, jo prejshim për veti. Kushtet unë nuk i kom pasë shumë të vështira, kryesisht të mira. U ni mungesa masi kom ra unë në burg, se ni rrogë ka mungu. Po ni kohë të gjatë, nja tri vjet e kom marrë 50 përqind të rrogës. Derisa u bo e plotfuqishme [vendimi i gjykatës].

Anita Susuri: E sa i përket shoqe,s për shembull kur ju kanë dënu...

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Qysh e ka pritë ajo qat' lajm?

Ajet Duli: Eh po dëgjo. Ma së keqti ka qenë puna e shoqes. Për arsye se ajo e ka pasë vllaun atëherë në pozitë, kha unë organizue krejt në anën e kundërt. Atina mikut nuk i ka ardhë mirë, se ju ka rrezikue pozita. Pastaj pasi unë kom ra, tani ka ra edhe vllavi i grusë. Kur ka ra edhe Mentor Krasniqi, vllavi i grusë, atij mikut Atëherë kta meniherë e kanë hjekë prej policie edhe e kanë kthy në Gjykatën Ekonomike si gjykatës.

Anita Susuri: E gruja juje e Prishtinës me prejardhje?

Ajet Duli: Osht' me prejardhje prej Mazginit.

Anita Susuri: E qysh ka ndodhë që jeni njoftu me to?

Ajet Duli: Në Normale kemi qenë ni gjeneratë.

Anita Susuri: Keni qenë bashkë.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: E pastaj thatë që në Zagreb, thatë që s'kanë pasë shumë mundësi me ju vizitu shpesh.

Ajet Duli: Po, në Kroaci.

Anita Susuri: Pastaj qysh ka vazhdu me vendet tjera, për shembull në Lepogllavë thatë që keni qenë njëmbëdhjetë muj.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu aty?

Ajet Duli: Po edhe aty qashtu. Rrallë ardhshin. Vetëm me letra shkrujshim, me letra kështu komunikojshim ma shumë.

Anita Susuri: Keni dërgu rregullisht?

Ajet Duli: Po, po.

Anita Susuri: A kanë shku letrat vazhdimisht?

Ajet Duli: Kanë shku po i kanë lexu, i kanë lexu. Kështu që, kemi qenë shumë të kujdesshëm çka me shkru.

Anita Susuri: A keni përdorë, për shembull naj kod për me shkru diçka?

Ajet Duli: Unë jo.

Anita Susuri: Se ka pasë që e kanë përdorë?

Ajet Duli: Nashta ka pasë, nuk e di.

Anita Susuri: Po mendoj diçka që me thanë po mos me u marrë vesh.

Ajet Duli: Jo.

Anita Susuri: Letrat kanë qenë sigurisht vetëm për gjendjen, si jeni...

Ajet Duli: Po, a jeni mirë, çka po boni, si po shkoni, si po kaloni, çka ka të re, a ka lindë kush, a ka deké kush.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Thatë që në Staragradishtë keni qenë me Adem Demaçin.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Qysh u nditë kur, kur, se ju keni qenë si, ka qenë si ndoshta kreu i qasaj organizate. Jo kreu po e keni shpallë si marshall në organizatë.

Ajet Duli: Unë kom qenë në mesin e 12-13 vetëve si na kanë pru në Staragradishtë, po me moshë kom qenë ma i vjetri prej qatyne që ishim aty. Kur shkum në pavijone atje u takum me Bacin Adem. Ademi veti, “Kush osht’ ma i vjetri?” A din, me moshë. Ma s’pari me mue kemi fillu me bisedu me Bacën Adem sikur qysh kom fillu me juve me bisedu prej fillimit...

Anita Susuri: Të jetës.

Ajet Duli: Të jetës time e masi jom bo me ditë e si ia kom shpjegue. Ama si me pasë prind temin, qashu e kom konsideru edhe asgja s’kom mshefë, po i kom tregu krejt realitetin qysh ka qenë. Qysh në atë kohë Baci Adem qaq largpamës ka qenë, qaq i përkushtum. Ndëgjo, nuk ka fjalë as fjalor si mund ta përshkrun Adem Demaçin. Ai osht’ shpirti, ka qenë shpirti dhe zemra e njerëzimit edhe e shqiptarisë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë për shembull qëndrimi i tij në burg?

Ajet Duli: I veçantë. Kush s’ka mujtë me thanë që qita e boni Ademi. Ai u konë i burgosun politik, po thojshin ata shkijet², “Armik, armik, po bravo i koftë se njeri osht’”. Nuk ka pritë ai për shembull me i thanë, shko merrni... se kur u kthejshim prej punës se i punojshim do kimika, na çojshin me punu veç për mos me na lanë me lexu ma shumë. Bojshim montimin e atyne kimikave. Kah u kthejshim Baci Adem nuk shkonte në dhomë atje, po i marrke do dru i qitke ktu edhe i çonte në dhomë atje. Vazhdimisht lexonte Baci Adem, lexonte. Qishtu me shokë, me çdo njanin.

Vlen me cekë se para sa ishim atje masi e krevja bisedën më tha, “Kqyre çka po të thom, s’dihet qysh na vjen puna ndoshta”, tha, “si kur të dalim nuk kemi me pasë mundësi m’u takue se kjo rruga jonë është e gjatë edhe s’i dihet. Por, në qoftë se të vjen ndonjë njeri që ta çoj unë edhe të thotë, ‘A je ti Ajet Tullari’, ti thuj, ‘Jo more s’jom Ajet Tullari, po jom Ajet Duli’, kur ta pash qëndrimin e tina i thu, ‘Po, po edhe Ajet Tullari jom’”, kjo ka qenë ajo marrëveshja. I thashë, “Pse bre bac pash Ajet Tullari?” Tha, “O bac”, tha, “kjo kulla jonë”, tha, “osht’ e madhe e qajo kulla jonë”, tha, “osht’ e ndërtime me tulla, e një prej tullave”, tha, “je edhe ti” (qeshë).

Anita Susuri: Për shembull, qysh ka qenë edhe sjellja e tjerve ndaj tij po mendoj po edhe e policëve?

Ajet Duli: Korrekte ka qenë. Ka pasë edhe disa prej nesh si fort s’ia ka mush synin Baci Adem. Ka pasë edhe të atillë që i ikshin bisedës me Bacin Adem, debatit me Bacin Adem. Ka pasë edhe asi. Bile më kujtohet ni rast ni herë për njanin tha, “O ishalla”, tha, “nuk vjen qiky”, tha, “në pushtet se”, tha, “ma i zi se qita që i kemi”, tha, “bohët” (qeshë). Se vijne në shprehje interesat edhe ambiciet karrieriste. Ne gjithkund si popull pak vujmë prej asaj dukurie kështu të karrierizmit.

Anita Susuri: Aty thatë që keni pasë si lloj pune që keni bo a?

² *Shka* (m.), *shkinë* (f.), shumë *shkijet*, term derogativ që shqiptarët e përdorin për serbët.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Ndoshta tetë orë në ditë e keni pasë si punë të zakonshme?

Ajet Duli: Po, po, tetë orë punë po. Ni kohë kemi punu në zduktari. I bojshim lustrimin e do karrikave, do tavolinave aty. Po merre me mend gjatë gjithë ditës aty si asishëm. Shumë herë kom qenë me Fehmi Lladrovcin, me Fehmi Shalën, me nifarë Abdyrrahim Magjuni, Abdullah Dërguti, Nuhi Ahmeti. U bojshim aty bisedojshim edhe kah tre-katër karrika nuk listrojshim ma shumë. Po qëllim ish mos me na lanë, po me na angazhu diçka.

Anita Susuri: A keni pasë për shembull naj dënim nëse nuk e keni përmbushë ni punë?

Ajet Duli: Jo, s'ka pasë. Se aty në Staragradishtë ka qenë sikur llogor, qashtu.

Anita Susuri: Ka pasë disa objekte?

Ajet Duli: Ka pasë shumë objekte. Ka pasë... ata që janë konë për delikte tjera i shtishin me punu edhe punë t'rana edhe i stimulojshin. Sidomos me vizita, i lshojshin për me shku në shtëpi. Mandej i pagunin diçka kshtuqë punonin punë t'rana edhe punojshin për shembull cisterne punojshin aty, cisterne t'mdha për me bajtë naft e qisi gjanash. I kanë pasë ata punëtortë, punojshin atje.

Anita Susuri: Për shembull, bisedat që i keni bo me Bacin Adem e tjetër, aty a keni pasë kujdes ndoshta mos ka ndonjë shpiun a diçka? Mos me folë për ni person tjetër?

Ajet Duli: Kqyre, na gjithmonë kemi folë në përgjithësi kështu a e din. E di për shembull ni rast, u tubum goxha shumë nifarë rrethi aty. Më doket ka qenë ditë e diel, atë ditë aty dhe ra biseda tema e natalitetit. Njani po i thotë, "Baci Adem bre, a po e sheh nataliteti osht' t'u na ra? Kjo dukuri është për me na brengosë të gjithëve", edhe u hap aty ni debat edhe kemi bisedu ni orë e tepër, a dy dhe ndoshta krejt rreth kësaj teme. Po në fund tha baci tha, "Kqyre, po shihet", tha, "se nuk osht' reni", tha, "ma se nanat tona", tha, "se i bojnë kah dhetë fmijë po na kur të dalim", tha, "do të dalim", tha, "dhe do të bajmë ni propagandë aty e t'ju themi se bile nër pesë mos metni".

Edhe osht' e vërtetë se tani kur dolëm prej burgu erdhën të [shkollës] "Zenel Hajdini" me më vizitu në shtëpi, kolektivi. Aty punonte edhe shoqja ime. Po e vetë ni koleg aty, "Shehide", thashë, "sa fmi i ki oj Shehide?" Tha, "Tri vajza e ni djalë", thashë, "Dëgjo, na", thashë, "kemi marrë vendim atje në burg", thashë, "si nër pesë nuk bon me e lanë", "O", tha, "tybën e la pa e bo edhe njo". Me të vërtetë e boni tani edhe ni djalë, e boni dy djem e tri vajza. Genti tashti u rritë edhe ka, jo doktoru po magjistru diçka në shkenca teknike. S'e di, për momentin më doket në Norvegji është dikund. Jashtë.

Anita Susuri: E ju thatë që bashkë me Bacën Adem pas Stara Gradishtës ju kanë çu në kësi...

Ajet Duli: Sllovenska Pozhega.

Anita Susuri: Sllovenska Pozhega.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë qiky transferim? Qashtu pa paralajmërim?

Ajet Duli: Pa paralajmërim, veç na kanë thanë, “Merrni sendet e juja çka i keni”. Edhe nuk e ditshim ku po na çojnë, veç na kanë çu. Kur kemi shku atje na kanë tregu se jemi në Sllovensko Pozhegë. Kemi nejtë dy netë e tretën e ditës na ka ardhë vendimi se jemi...

Anita Susuri: Liru.

Ajet Duli: Jemi liru prej burgut me urdhër të RSFJ-së, atëherë u konë nifarë abolim i thojshin.

Anita Susuri: E pse veç për dy-tri ditë me ju transferu atje?

Ajet Duli: Kumeditë qëllimin e tyre për çka ka qenë. Ndërkohë ktu e kanë pa përhap ni lajm që u lshu Adem Demaçi edhe në Lupç po i pret njerëzit. Qytetarët tani janë konë pa tubue ni numër i madh janë shku në Lupç duke mendue se u ardhë Adem Demaçi. Ai s’u konë veç na dëgjum edhe atje se diçka po.

Anita Susuri: E qitu dashta me ju pytë, a keni pasë për shembull lajme me lexu a gazeta?

Ajet Duli: Gazeta po.

Anita Susuri: Jeni informu.

Ajet Duli: Na ardhshin gazetatat edhe i lexojshim. Po e kemi majtë edhe ni radio si ilegalisht e majshim. Atë radio e kem pasë për detyrë herë njani, herë njani e marrshim edhe kur shkojshim me ra me fjetë deri vonë me dëgju edhe të nesërmen kur dalim atje me tregu çka ka të re.

Anita Susuri: Me tregu krejtve domethonë?

Ajet Duli: Po me tregu krejtve se...

Anita Susuri: S’ju kanë gjetë atë radion a?

Ajet Duli: Unë thashë aty s'ka pasë fort disiplinë, s'ka pasë fort kontrollë anej knena. Se nëpër burgjet hetuese me nder me thanë para jush, na çveshin lakuriq bajagi po na kontrollojnë.

Anita Susuri: A e keni ditë ju datën e saktë që po dilni pak ma herët apo ju ka ardhë befasi?

Ajet Duli: Befasi. Na i përcillshim lajmet, ishim në ngjarje se po ka fillu disa procese. Tasht po saktësisht nuk e dishim. Derisa na njoftun qat' ditë kur na lëshun se...

Anita Susuri: Ju ka ardhë ndonjë vendim apo...

Ajet Duli: Ju ka ardhë vendimi edhe na i dhanë, u nënshkrum atje edhe, "Jeni të lirë".

Anita Susuri: A u gëzuté ju, a qysh e pritët qata?

Ajet Duli: Po ndëgjo bre, diqysh nuk kemi qenë të kënaqun, se mirë e kish Baci Adem që thonte, "Ne jemi konë me ni burg të mbyllur e po dalim me ni burg të hapun". Kur jom ardhë unë në shtëpi për shembull, vllau u dalë në Fushë Kosovë më ka pritë e më ka marrë. Kur erdha vllaznit ma kishin ndreqë ni shtëpi, e kishin shti nër kulëm. Nja dy dhoma i kishin meremetue diqysh. Kështu që, unë kur erdha shkova në shpi, e gjeta grunë, çikën edhe dy prindat ishin konë me to aty. Ajo gjysë e ndërtume, gjysë... deri vonë. Po masi kom dalë prej burgut kushtet shumë të randa, shumë të vështira. Prapë m'u deshtë me ia nisë m'u marrë me i ble do lopë e në podrum poshtë i mbajshim loptë, naltë fjetshim edhe shitshim do tamël edhe qashtu për kijamet.

Anita Susuri: Thatë që prej burgut, po mendoj prej këtij Sllovenska keni ardh prej Sllovenska Pozhegës me tren ktu?

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Sa keni udhëtu gjatë? A ka qenë rrugë e gjatë?

Ajet Duli: Rrugë e gjatë kur në mëngjes kur kemi në mramje kemi mrrri kha.

Anita Susuri: Familja e ka ditë? I keni lajmëru paraprakisht?

Ajet Duli: Po, po, e kanë ditë.

Anita Susuri: E që thatë në familje kur keni ardhë, qysh ju kanë pritë familja?

Ajet Duli: Po mirë bre familja.

Anita Susuri: A ka pasë njerëz që kanë ardhë shumë apo?

Ajet Duli: Ka pasë se në qat' kohë veç filloi nifarë liberalizimi i çashtjes në përgjithësi. Tani edhe njerëzit kishin dëshirë pak me u tregu, se gjatë kohës kur kom ra në burg e kur jom dënu sado kudo njerëzit kanë ngurru. Janë frikësu me ardhë me u pa aty rreth familjes time, rreth asajna, se në nifarë mënyre si armiq na patën shpallë.

Anita Susuri: E ju thatë që pas burgut e keni pasë të ndalume me punu ni kohë.

Ajet Duli: Po. Gjashtë vite e kom pasë të ndalume, po në '90-ën veç fillunë me punu me planprograme të Kosovës. Erdh tani qajo...

Anita Susuri: Shtëpitë-shkolla që janë bo...

Ajet Duli: Po. U bonë shtëpitë-shkolla kto shkollat fillore nuk i patën mbyllë. U hap ni konkurs aty në shkollën "Nazif Gafurri" është qujtë atëherë. Unë prej qatyhit kom pa dalë, po veç u konë "Zenel Hajdini" u qujtë e tani u bo shkollë e re edhe e ka marrë emrin "Nazif Gafurri", edhe sot e asaj dite është aty. Unë në '92-tën fillova, në shtator u ktheva si arsimtar i fizikës. Kom punu aty deri në '99-ten. Në '99-ën gjegjësisht në 2000-tën, se unë tasht isha edhe në polici ushtarake...

Anita Susuri: Qatëherë keni hi në polici, mas luftës?

Ajet Duli: Jo. Unë me 16 qershor '98-ën jom kyç në UÇK edhe zyrtarisht. Sepse unë gjatë qisaj kohe, viteve '90-a prej '96-ës kom qenë në Partinë Parlamentare të Kosovës edhe Baci Adem pat' aderu në Partinë Parlamentare edhe Bajram Kosumi ka qenë në atë kohë kryetar i Partisë Parlamentare. Ia pat' lëshu vendin, u konë pa bo kryetar i Partisë Parlamentare, Adem Demaçi. Tani krejt na çka kemi qenë, se unë kom qenë niherë në LDK, aktivist i LDK-së. Masi Baci Adem kaloi në Partinë Parlamentare, atëherë na ju bashkangjitëm Partisë Parlamentare. Për arsye se në atë kohë ishte qëllimi që të formohet ni parti e cila do të jetë përkrahëse e UÇK-së.

Osht' e vërtetë se Partia Parlamentare në atë programin e vet e ka pasë për zgjidhjen e çashtjes së Kosovës edhe me mjete të tjera. Jo vetëm jo-violente, po edhe me mjete tjera, domethonë si edhe me luftë. Unë në qat' organizim kom qenë kryetar i Partisë Partlamentare - Dega Gërmia. Ajo e ka përfshi qët' pjesën e Gërmisë naltë. Nysret Pllana ka qenë për Kodrën e Diellit. Liman Veseli ka qenë për Kodrën e Trimave, Shefqet, Shefqet ni Shefqeti qitu e ka pasë, s'po më kujtohet tash mbiemri, ai ka qenë për qendër, kryetar i partisë. Ni Hashani ka qenë për Dardania. Kështu që, u formu nja pesë-gjashtë degë të Partisë Parlamentare edhe i mbajshim mbledhjet për, bashkë me Bacin Adem në atë kohë. E kemi pasë ku u konë Ibrahim Rugova afër atij i kem pasë zyret parlamentare. Gjatë viteve '97, '97 qashtu, '98 e...

Anita Susuri: E po më intereson edhe për këto shtëpitë-shkolla, qysh ka qenë organizimi? Ku keni pasë për shembull klasë a?

Ajet Duli: Vllavi jem e ka pa lëshu shtëpinë, Gani Duli, e ka pa lëshu shtëpinë, qashtu e ka pa bo shkollë. Ni kat e ka pa lëshu shkollë, ni kat ka jetu vet, se u konë shtëpia dy kate.

Anita Susuri: Aty keni qenë?

Ajet Duli: Po. Kryesisht kanë ardhë prej shkollave të mesme, qaty [shkolla] “Eqrem Qabej” kanë majtë mësim ktu në shtëpinë tonë. Po në vitin ‘91-‘92 në Mitrovicë kanë qenë disa djem dhe vajza në jetimoren e Mitrovicës edhe me shkatërrimin e sistemit ata deshtëm me i çu për Serbi. Përmes LDK-së u konë pa hap ni lajm, kush po don me i marrë ata fëmi për mos m’i lanë me shku në Serbi. U morëm vesh unë e vllau me marrë nga një, ka ni fëmi. Kunata ime tasht e ndjera se ka vdekë e murrë ni vajzë po metë me marrë tashti edhe unë po me folë me shoqen time, me bind ata për me marrë edhe na njo.

Shoqja tha, “Vallahi”, tha, “s’po muj m’i majtë qita fëminë e mi”, tha, “e po marrë”, tha, “fëmi të hujë”, tha, “po iki”, tha, “prej sevapës po hi në gjyna”, po. Tani ajo kunata ra goxha në pozitë të keqe. Tha, “Hajt”, tha, “se i marrë unë te dyjat”. I ka marrë. S’po du me përmend emrin tash, veç kryesore i kemi rritë. Njana prej tyne është martu ka fëmi, jeton në Hajvali. Kurse tjetra osht’ në Shkollë të Lartë Pedagogjike, e ka punësu vëllau aty. Jo në Shkollë të Lartë, po në Akademi të Arteve punon si zyrtare por s’u martu hala.

Anita Susuri: Shumë mirë.

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: Edhe fëmitë e tjerë që kanë qenë, a veç këto vajzat që kanë qenë në rrezik për me shku?

Ajet Duli: Jo, kanë qenë edhe disa tjerë, po na kta i kemi marrë edhe na i kemi rritë edhe me nifarë mënyre i kemi shpëtu për mos m’i çu në Serbi.

Anita Susuri: Po, po. E me punu në shtëpitë-shkolla, çka u konë ma vështirë? Masi s’ka pasë, s’u konë si klasë klasike ajo.

Ajet Duli: Po, po. Kanë qenë kushtet e vështira. Pa banka, pa karrika, krejt të improvizuara. Tani edhe mësimi ndryshe është me sistemin e organizum të arsimit.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj këto vitet e fundit që u afriu lufta? Ju thatë që...

Ajet Duli: Qe veç po ta marrë shembull. Për shembull shkollën “Nazim Gafurri”, aty punohej në katër turne. Kur ia fillojshim në mëngjes me klasë të nanta, tani ardhshin klastë e ulta, orari ishte i shkurtuar kah 30 minuta. Ardhshin të fakulteteve tani edhe ni turnë. Tani edhe ni turnë krejt vonë dikur. Merre me mend çfarë pluhni e çfarë zhurme e çfarë haj medet haj. Në qato kushte u dashke me punue. Punëtortë me pastrue me mbajtë nifarë higjiene, po sa njeri hijke, sa dalke, sa zhurma u krijojke aty haj medet haj.

Anita Susuri: E a keni pasë problem ndoshta me policinë najherë a diçka?

Ajet Duli: Po valla edhe me polici. Edhe me polici kemi pasë shpesh herë. Ata ardhshin po më kujtohet në qat’ kohë u kanë edhe nifarë policie lokale. E në qat’ farë policinë lokale janë konë edhe do shqiptarë edhe ata tani ardhshin edhe e mbikqyrshin edhe na përcillshin edhe neve çka po bojmë, tek po bojmë.

Anita Susuri: E ju personalisht a keni pasë ma probleme me policinë? A ju kanë marrë prapë në pyetje pas burgut?

Ajet Duli: Pas burgut, dy herë më kanë marrë në pyetje. Niherë më kanë marrë ‘93-tën se kom qenë kryetar i aktivitet të LDK-së e 9/1 u qujke ajo. Patëm majtë ni mbledhje në Bledi 2 atje te ni Miftar Krasniqi. Ni tubim me qytetarë. Tasht dikush u shku ka lajmëru se qishtu qishtu po mbajnë takime me qytetar në filan vendi. Më morën mu edhe e morën, unë si kryetar edhe sekretarin e atij. Na çunë në Mahallë të Muhaxherëve aty edhe u konë ni polic aty, na mori në pyetje. “A i keni mbajtë mbledhjet?” Unë thashë, “Po”. “Ani”, tha, “s’o problem edhe na e dijmë”. Thashë, “Edhe na e dijmë”, thashë, “se LDK-ja është e regjistrueme në Beograd osht’. Na... ju e dini si e kemi kryesinë, e kemi kryetarin, i kemi këto degët e nëndegët. Unë jom atje kah fundi”. Po ai sekretari si ishte me mue, si e morën edhe atë, ai në atë kohë punonte në doganë, sekretar i doganës. Ai s’kish pranë se i kishte majtë ato e tani na ballafaqun aty. Thashë, “O Rexhë s’kemi bre pse majmë msheft...”

Anita Susuri: Po.

Ajet Duli: “Kjo osht’ legale i kemi majtë, kta e kanë për detyrë me vëzhgu, me i pasë”. Nejse. E pruni ni qytetar të lagjës tonë aty edhe më thanë, “Qyrne tash e tutje, ju mani [mbledhjet] s’o problem. Po veç me ditë, veç m’i tregu qitij qytetari, ky na tregon neve edhe kryhet kjo farë pune”. Unë s’pranova i thashë, “Nuk, nuk i jep aty kërkuna llogari”, thashë, “për këtë punë. Unë kry punën tem, ju kryni punën tuaj”. Atë e lëshun, atë sekretarin, a mu më çunë në 92-sh poshtë atje. Më morën në pyetje, hym atje. Bile më kujtohet nja dy faqe të A4 e kom bo me shkrim edhe e kom pa dorëzue në degën e dytë të LDK-së. [Selatin Novosella](#) ka qenë kryetar atëherë. Ai shkrim është dikund për të drejtat e njeriut, në Këshillin për të Drejtat e Njeriut osht’ edhe ruhet. Sigurisht me shku me lypë ndoshta edhe gjindet.

E kom shpjegu krejt qysh na ka marrë policia, qysh kemi shkue, çka kemi bisedue, çka na kanë thanë, çka krejt i kom përshkru edhe e kom dorëzu degës në atë kohë. Në qat' kohë s'më kanë pa malltretue. Po ndërkohë ni nxans i imi e bjen ni veturë edhe më thotë se, "Vallahi s'po kom ku me lonë veturën a bon me pru qitu në oborr tanin?" Thashë, "Qyre Agim, ki kujdes se ti e din qysh e kom gjendjen unë", thashë, "nëse është diçka e dyshimtë mos më nxirr telashe", "Jo, arsimtar veç unë po shkoj jashtë e kur kthehna vi e marrë, veç s'po kom ku me lanë".

E kta serbët i... u konë postieri që e pruke postën po jo vetëm postier po ai kryente edhe shumë veprime tjera. E ka pa aty veturën e parkume në oborrin tim edhe e vetë babën, "E kujna osht' kjo veturë?" Vijnë policia, "Kush, qysh?" Del se e ka pru ai nxansi jem, m'u deshtë me tregu. Thashë, "Filani e ka pru, e ka lanë qe ku osht' vetura". E morën veturën e tani më morën edhe mu shkum te baba e atij nxanësit me polici. E t'më çunë tani në 92-sh e t'më rrehën, e t'më rrehën, t'më bonën llom, se, "A e din ti se me atë veturë janë bartë armët?" Ata veç si shkas se ju ka ardhë inati shumë si e kom shkru qato, atë shkrimin atëherë...

Anita Susuri: Po.

Ajet Duli: Edhe e kom dorëzu atje. M'u hakmerrën. Kjo ka qenë '94-tën, qat' kohë kur më ka lindë edhe djali. Më kujtohet si... vajza qatëherë, kjo gruaja veç 40 vjeçare ishte momenti i fundit i kishim dy vajza na lindi edhe ni djalë edhe po.

Anita Susuri: E prej ktyne torturave, dhunës fizike, a ju ka mbetë kështu ndonjë pasojë në shëndet?

Ajet Duli: Po. Harresa m'u ka paraqit me të madhe, të tregova parzit qysh ma kanë qit' ata në çaj edhe prej atëherë m'u ka paraqit harresa goxha e madhe. Tasht ndoshta edhe pleqnia pak. Vetëm njo po ju thom, si prej si jom bo kurrë niherë në ymer tem s'ia kom shtri kujna dorën as nuk jom përkulë, por gjithmonë me mund e me sakrificë e me angazhim i kom krijë kushtet e jetesës. Të vështira, të vështira, por pa ndihmën e kërkujna po krejt me... edhe sot e kësaj dite e kom ni kopsht aty te shpija ime, e kom ni bashçe, mbaj do pula. Kështu që, gjithmonë kom qenë shumë aktiv edhe gjithmonë kom punu, kom jetu prej ndjersës time.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Tash, e përmendet ma herët që '98-ten jeni antarësu domethonë në UÇK...

Ajet Duli: Po.

Anita Susuri: E ku keni qenë? Çfarë brigade ka qenë? Qysh ka qenë situata qatëherë?

Ajet Duli: Qyre, unë kom qenë në kontakt të përhershëm me Adem Demaçin...

Anita Susuri: Po.

Ajet Duli: Asni veprim në jetën time prej si jom dalë prej burgut nuk e kom ndërmarrë pa u konsultu me Bacin Adem. Shpesh herë ka ardhë edhe në shtëpinë time Baci Adem. Na ishim të interesum si organizim sa ma shumë me angazhu edhe me i çu në front për me luftu, se u pa se me mjete paqësore s'po zgjidhet çashtja e Kosovës. Unë... vazhdimisht i mbajshim mbledhjet edhe e informojshim Bacin Adem qysh po shkojnë rrjedhat, qysh o puna. Gjithnji bojshim nifarë testimi, a ka dikush si po don m'u bashkangjitë. Ndërkohë unë rash në nifarë lidhje edhe u bom nja tre anëtarë të kryesisë të Partisë Parlamentare që ishim Dega Gërmia. Unë, Sabit Mushica, tasht osht' i ndjerë, edhe Nexhmedin Sherifi, osht' ni advokat tashti osht' t'u punu ktu në Prishtinë. Na u bashkangjitën edhe ni Nazim Cakolli edhe Fadil Dibrani. U bom pesë vetë për të gatshëm me shku me ushtru në UÇK. E njoftova Bacin Adem, qishtu qishtu.

Me 16 qershor '98-ën në [shkollën] "Nazim Gafurr" e kemi pasë mbledhjen e fundit të shkollës aty. Jemi përgatitë me do çka kemi mujtë me marrë diçka ni valixhe me veti, do patika, do... edhe kemi shkue. Jemi nisë ktu në Prishtinë, kemi shku në Podujevë. Prej Podujevë kemi shku në fshatin Zabërgjë, komunës të Mitrovicës atje osht' ni fshat shumë i lashtë atje. Kah jom shku anena kom ra, kom bisedu me nji i cili ishte ma herët në UÇK aty, komandant Korabi. Osht' i njohur Parduzi mbiemrin e ka. I tregova si kom qenë i burgosur politik edhe kam qenë i dënum me Mehë Ukën. Ai kishte qenë shok me Mehë Ukën në shkollë. Kur kemi shkue në Zabërgjë atje, kemi bujtë atë natë. Ai e kish njoftu komandantin Kadri Kastrati, ka qenë komandant atje. E kish njoftu se qishtu qishtu, "Osht' ni i burgosur politik. Ish ardhë edhe ish shok i Mehë Ukës", ai thotë, "Birma", thotë, "nesër në mëngjes", thotë, "të bisedoj unë me të".

Në mëngjes herët u ardhë ai komandat Korabi ma ka pru ni baretkë me UÇK, me shkronja edhe ma ka vu në kokë. Kështu që, na kemi qenë grupi i parë i Llapit që kemi shku me ushtrinë në Zabërgjë. Njeri i parë (buzëqeshë) i cili e ka vu stemën e UÇK-së në kapele kom qenë unë, ma ka vendosë ai. Kom shku te Kadri Kastrati me bisedue. Kur shkova aty më priti mirë ai, e kish kuptu se jom konë i burgosur politik edhe më tha, "Ti pak qenke si në kohë, e kësi njerëz na nevojiten po na nevojiten me punu në qytet. Për ni ushtar ktu duhen dhetë njerëz me punu në qytet për me majtë ni ushtar. A p'e shihni, nuk kemi armë të mjaftueshme, nuk kemi ushqim, nuk kemi kushte, nuk kemi njerëz adekuat. Po me kqyrë me i gjetë edhe na plagosun njerëzit, ku m'i çu, çka me bo me ta?" Thotë, "Ti duhesh m'u kthy", thotë, "edhe me veprue në qytet me vazhdu punën". Kthehna unë të nesrit, vi te shpija i la ata.

Kthehna me qat' Nazim Cakollin se edhe ai pak moshatar i jemi edhe ai, na dy ma të moshum ishim edhe murrëm detyrat bashkë me punu ktu në qytet. Unë shkova edhe i tregova Bacin Adem që qishtu qishtu. Po, më pat' porosinë ai Kadri Kastrati, Sylejman Ajeti osht' ni vendas i jemi ka qenë me gradë kolonel, a nënkolonel, a diçka në armatën jugosllave. Bile ai Sylejman Ajeti e kom pa qitë unë në

kontakt me Ali Dulin, ni kusheri i jemi ka qenë edhe gjyshi i Albulena Haxhiut. E kom pa lidhë këtë Sylejman Ajetin me Ali Dulin edhe me, me këtë Haxhiun edhe tani kta, ky ushtaraki i ka dhanë informacione Bacit Ahmet për gjendjen e armatës jugosllave qysh osht' organizu, ku janë depot, çka janë informatat. I ka pa marrë Ahmet Haxhiu përmes qitina Sylejman Ajetit.

Ai komandanti atje tha, “Me mujtë”, tha, “me pru”, tha, “Sylejman Ajetin”, tha, “se ai osht' inxhinier i diplomuar”, tha, “edhe e ka kry”, tha, “në Zagreb është shumë i aftë për inxhinieri, e na u kish nevojitë shumë”. Shkova i tregova bacit. Thashë, “Qishtu më ka thanë për Sylejmanin”, po Sylejman Ajeti ka qenë këshilltar i Adem Demaçit për çashtje ushtarake. Më tha Baci Adem tha, “Qyre”, tha, “në qoftë se pranon”, tha, “ai me shkue”, tha, “shumë punë kryen”, tha, “me shku atje në front”, tha, “sesa me kanë këshilltar i jemi. Po, me ia imponue”, tha, “jo. Shko ti tregoji qysh osht' gjendja, në ia marrtë menja le të shkon, mos ia marrtë le të rrin”.

Shkova unë kontaktova me ata, me Bacën Sylë, i tregova qishtu qishtu thashë, “Edhe po kanë dëshirë ti me shku atje”, tha, “Jo”, tha, “unë jom këshilltar i Adem Demaçit”, tha, “edhe”, tha, “s'muj”, tha, “në dy vende me asi”, thashë, “Ani, Baci Sylë, ku ta merr menja ty që mund me dhanë kontributin ma shumë”, tha, “Jo”, tha, “qitu e jepi ma shumë”. Ai s'vanoi shumë tani e morën policia, e zunën ata e Albinin, i burgosën te dytë. Tani fati ni, se na qaty, ku, ku rrijke Baci Adem edhe Albini, na qaty i kem pasë të njejta zyre, qaty e zhvillojshim aktivitetin e partive politike, Partisë Parlamentare.

Anita Susuri: E lufta qysh ka qenë?

Ajet Duli: Lufta, unë, s'vanoi shumë u plagosën dy të Shalës atje në front edhe m'i prunë mu ktu në Prishtinë. I vendosëm, ju gjetëm vendet, i vendosëm nëpër shtëpija me rrezik të jashtëzakonshëm. Ni kohë i patëm vendosë në shtëpinë e Nexhmedin Sherifit, ai si mbetë me ushtru atje. Ndërkohë, ju kom pa ndrrue vendin se u frikësojshim se mos po bjen në fije policia, dikush po shpahunon. I kemi pa çu te ni arsimtar i matematikës, koleg i imi, Afrim Shehu. Me respekt po e përmendi këtë emër, shumë burrë i mirë e Covidi i ka ra edhe ka vdekë. Ai e pat' marrë qata të plagosunin e ka pa majtë edhe e ka pa rreziku krejt familjen edhe ndoshta edhe lagjen. Po dha Zoti diqysh mbaroi ajo.

Ai osht' hala gjallë, osht' Sherif Rama, osht' invalid i cili e ka njanën kamë tash, osht' invalid në Mitrovicë. Edhe njo pesë-gjashtë muj qashtu unë kom qenë i lidhun me... u konë ni për çashtje sociale në kuadër të LDK-së edhe unë tasht ardhsha i marrsha të hollat, i blejshim çka u dufke edhe ju çojsha atyne të plagosurve edhe tjetërkush u interesojke për çashtjen e shërimit të tyne. Unë e kom pasë për furnizim, e për ushqim e qito për me ju caktu vendin ku me nejt. Dy të plagosur kanë qenë.

Kryesisht jom marrë me ta, por jo vetëm me ta po krejt kur ardhshin gjatë natës, ardhshin nga fronti, u vendosshin ktu në qytet natën. I ngarkojshin me ushqime, me krejt çka, me barna me çka ish edhe na i përcjellshim natën deri diku edhe ata shkojshin në front na u kthejshim në shtëpija tona këtu. Unë kom

nejtë në Prishtinë. Bile, me tërë familjen si ka qenë shumë rrezik i madh po e patëm vendosë, se u dufke me mendu edhe për UÇK-në. Se UÇK-ja në qoftë se nuk ka pasë njerëz, nuk mundte me vepru.

Anita Susuri: A keni qenë në shtëpinë e juv apo keni lëvizë?

Ajet Duli: Kemi lëvizë. Jo, tanë kohën në shtëpi.

Anita Susuri: E koha kur kanë fillu bombardimet?

Ajet Duli: Koha kur fillunë bombardimet, qatëherë ju dulë pak gjumi shqiptarëve. Kur e panë se s'kemi kah ia mbajmë përpos ja me u nënshtrve, ja me dalë me luftue. Unë e kom pasë për detyrë edhe prej atij Kadriut, po edhe prej Bacit Adem sa ma shumë me mujtë me rekrutu edhe me, me çue në front. Po masi filloi NATO me bombardue s'kish armë, s'kishim ku me i çu. I çova nja dy djem atje në Zllashë, atje me kqyrë qysh osht' gjendja. Kur u kthynë thanë, "Jo vallahi, s'po... s'ki ku i çon".

Anita Susuri: Ishit t'u na tregu përgjatë bombardimeve...

Ajet Duli: Po, gjatë bombardimeve fillunë do djem m'u interesu qatëherë po unë mora informata se atje nuk kanë armë, nuk kanë edhe ushqim rrezik edhe u thashë, "S'keni, s'muj me iu çu tashti, u bo veç vonë". Po osht' interesant me cekë ni rast. Ni Ramadan Brajshori, ni kojshi joni, se unë rregullisht dalsha, bisedojsha me njerëz edhe e matsha pulsni pak, qysh, çka po thojnë, çka po mendojnë. Në bisedë e sipër po i thom, "O Dan, u ardhë ni kohë si po duhet me ndrrue veprimin tonë, se me mjete paqësore nuk, nuk po mujmë me kry gjo. Po na nevojiten njerëz s'po janë të gatshëm me marrë pushkën edhe me dalë me luftue. Ja, kjo nuk osht' jetë kështu", tha, "Kqyre Ajet", tha, "unë jom prind e s'muj", tha, "po ti", tha, "bisedo me Remziun djalin tem", tha, "në qoftë se osht' i gatshëm le të shkon mor", tha, "se nime pa luftue s'fitohet liria".

Unë tani pata bisedue me qat' Remziun, po ishte vonë edhe kjo. Se kqyre çka, pasha nerën vërtetë shumë pak kemi qenë për luftë. Bisedova me ta, "Po", tha, "unë jom i gatshëm", po u bo vonë edhe ai masi intervenoi NATO. Si thashë, unë i pata çu njerëzit atje edhe u kthynë më tregunë se nuk ka mundësi me çue, se ka... po s'po kanë armë njerëzit me luftu. U paraqit rreziku masi intervenoi NATO. Fillunë, për shembull Bajram Kelmendin e vranë, Fehmi Aganin, ishin të rrezikum Mehmet Hajrizi edhe...

Anita Susuri: [Hydajet Hyseni](#).

Ajet Duli: Hydajet Hyseni. Unë i krijova lidhjet edhe ni mbramje thashë, "Me ardhë se po ju përcjellë". Erdhën Mehmeti dhe Hydajeti dhe ni mbramje natën i kom kalue nëpër Gërmi e i kom qit' deri në fshatin Mramor atje.

Anita Susuri: E kështu tash, gjendja e luftës në qytet qysh ka qenë?

Ajet Duli: Po kqyre, në Prishtinë s'ka pasë luftë.

Anita Susuri: Për shembull, kur i kanë largu prej banesave për me shkue...

Ajet Duli: Po, ata vazhdimisht kanë bo presion se kur herën e parë kur i kanë qit' qytetarët i kanë njëkë prej Prishtine unë kom qenë në Zllashë.

Anita Susuri: Veç vet, a me familje?

Ajet Duli: Jo, vetëm kom shkue në Zllashë atje edhe jom takue e kom pasë ni nxanës timin si, Rrahmon Dini, bile kom qenë bashkë me to edhe në burg në Mitrovicë kom qenë ni dhomë me të, atë Rrahmon Dinin. E tani unë shkova atje në, në fshatin e Mitrovicës atje për me ushtrue. Pata bisedu me ta, po ky me Fatmir Sopin fillunë, e bonën organizimin në Zllashë atje. Unë shkova me detyrë diçka shkova, s'po m'kujtohet tash çka. I takova atje... a po, kur i kom qit' Hidajetin edhe Mehmetin tani shkova deri në Zllashë thashë ta kqyri qysh osht' gjendja atje. U takova me atë nxansin tem edhe ai më tregoi qysh osht' puna krejt edhe unë tani të nesrit u ktheva për me hi në qytet.

Kur vi në Kolovicë, aty kolonat e njerëzve krejt t'u ardhë, t'u ikë për Gollak atje. Ndërkohë, u takova edhe me familjen time si... gruja me fëmi, vllau, baba edhe nana kishin mbetë në shtëpi. U vendosëm në ni fshat aty, familjen. Edhe të nesrit unë... megjithatë ishte rrezik shumë i madh po u ktheva në qytet. Shkova te prindët thashë të të kqyri. Hina në qytet si s'ma ka pa marrë menja, thojsha veç me luftë se ndryshe nuk hijmë, po qe, u krijunë kushtet edhe prapë unë hina në qytet natën. Shkova te prindët, nejta aty edhe u ktheva apet, shkova te familja atje. Majsha qat' farë lidhje qashtu. Po sikur e kisha nifarë intuite se ma rrezik ka m'u bo atje, se mund me hi ndonjë ofenzivë sesa m'u kthy në qytet.

Bisedoj unë me shoqen, thashë, "Qyre çka, ma rrezik jemi qitash kha sesa me kanë në qytet. Pse? Se qyteti u, u boshatisë". O veç do qen, e do pula e do gjela se s'u nijke inson i gjallë, as njeri s'u doke në qat' pjesën ku jemi konë na. Do pleq ishin pasë mbetë nëpër shtëpija edhe ata të rrezikum po... i kom marrë familjen e i kom pru, i kom vendosë apet në Prishtinë.

Anita Susuri: Keni udhëtu në kamë, a qysh keni ardhë?

Ajet Duli: Krejt në kamë, krejt në kamë. Masi jemi vendosë aty, te dera e shtëpisë time e kanë vra ni arsimtar të Nishevcit. Unë kom qenë aty edhe kom dalë e ia kom qit' ni peshqir për ftyre edhe gruja e tina ka qenë. E mora e shtina në oborr aty. U përhap lajmi se më kanë vra mu. Bile, s'e di sa asi radio stacione e kanë pa përhapë se osht' vra Ajet Duli, e kanë vra policia. A në realitet s'më kanë vra mu, po e kanë vra qat' arsimtarin e Nishevcit, ni kojshi tonin aty.

Anita Susuri: Veç e kanë gjetë në rrugë qaty?

Ajet Duli: Vallai nja 250 metra larg e kanë shti në nishan, u kanë nifarë njësie si veprojke atje edhe kryesisht gjatë luftës kanë vjedhë ata ma shumë. Po zaher edhe egjeli i tina, e mytën njerin. Isa, Isë e ka pasë emrin ai, msusi Isë.

Anita Susuri: Pastaj çka ndodhi me atë njerin? Se u kanë rrezik edhe m'u vorros.

Ajet Duli: E po. Metë ai aty, erdhën tani një njësi e veçantë për me bo obduksionin. Kur erdhën aty t'mu flukën mu, "Pse ti po rrin ktu? Pse po rrin, çka po pritni ju? Pse s'po shkoni? Hupni mos t'ju shohim, mos të vijmë me të ju gjetë ktu". Apet i morëm na, u nisëm na me lshu aty. M'u përhapë ajo se po ikim edhe na. E ndrrum, shkum me ni tjetër lagje (buzëqeshë). U vendosëm e tani apet shkojsha se i kishim do gja [lopë], i kishim do gja u dashke m'u interesu ka pak edhe qishtu.

Anita Susuri: Deri në shlibim qashtu.

Ajet Duli: Po. A kijameti i kijametit u kanë qat' natë kur në Kumanovë u nënshkru ajo...

Anita Susuri: Marrëveshja.

Ajet Duli: Marrëveshja. Nuk ka pasë lagje, as nuk ka pasë shpi në qat' pjesën e Gërmisë që nuk ka pasë ushtarë shkje. Krejt çka kanë pasë mundësi t'u ju rrah dyrve të metaleve, zhurmë e llahtashme u shku edhe t'u qit' me automatika e me armë. Vallahi, vajza e madhe prej atëherë m'ka mbetë pak me traumë, se kemi pasë frikë të jashtëzakonshme po. Edhe shoqja u tutë shumë edhe ajo vajza madhe. Këta dy fmija vegjël apet ma...

Anita Susuri: S'kanë ditë.

Ajet Duli: S'kanë ditë shumë. A ajo vajza e madhe pak ka mbetë pak me nifarë frike.

Anita Susuri: Kështu qyteti a ka qenë i rrënum, i shkatërrum?

Ajet Duli: Jo shumë. Aty ktu ndonjë shtëpi e kanë kallë. Po ka qenë ni dukuri se hishin paramilitarët edhe e lshojshin ujtë, çdokund e lshojshin për m'u shkatërrue. Aty ktu e kallshin ndonjë shtëpi.

Anita Susuri: E dita kur kanë hi forcat e NATO-s...

Ajet Duli: Gzimi ma i madh ka qenë kur ka intervenu NATO-ja në jetën time edhe kur kanë ardhë forcat. Te na kanë ardhë forcat angleze edhe janë vendosë bash te shtëpija e qatij Afrim Shehut që të tregova, ai arsimtar i matematikës ku ka nejt ai i plagosuri. E prej atyhit u vëzhgojke Sofalia ku sa mujshin me

kallë shtëpija ushtria serbe në Sofali atje. Se përpara ka qenë fshat i serbëve edhe ndërkohë fillunë m'u tërhjekë. Po sa automjeti, e sa [auto]blinda, e sa mjete ushtarake kishin qenë në Gërmi, mentë me të lonë. Kolonë, kolonë, kolonë nami i namit të njerëzve edhe teknikës ushtarake ishin kanë, si m'u habit njeri.

Anita Susuri: T'u e shliru Kosovën...

Ajet Duli: Po. T'u ikë nga Kosova.

Anita Susuri: E qysh jeni sistemu pastaj? Jeni kthyer në shpi, shpija s'ka qenë e shkatërrime ose diçka...

Ajet Duli: Jo, s'ka qenë.

Anita Susuri: Keni fillu, tani thatë në polici keni fillu me punu?

Ajet Duli: Po, unë me ta thanë të drejtën e kisha, isha arsimtar t'u punu. Po ndërkohë do shokë më thanë, "Duhet me ardhë edhe ti në polici ushtarake". "Pse bre? Jom në arsim qatje, mirë jom", tha, "Kqyre çka, pasha nerën", tha, "kta të zonës të Llapit", tha, "i kanë pru krejt njerëzit e vet", e tha, "po dojnë", tha, "m'i vendosë", tha "kuadrat krejt të vetat". Shkova unë te Baci Adem, prapë i tregova qishtu, qishtu. Tha, "Jo bac", tha, "qitash me randësi të jashtëzakonshme", tha, "osht' me mujtë me formu na ni polici të vërtetë", tha, "e cila ka dinjitet, e ka integritet, e ka kulturë e ka mençuri edhe mos kujto", tha, "se po na vijjnë të jashtit për ne ktu. Kta po vijjnë për m'i rujtë shkitë, se jo neve. Edhe duhet me pasë kujdes qysh po punoni, qysh po veproni. E me depërtu në lëkurën e tyre edhe me përfitu edhe ata m'u tregu se edhe na jemi të zotët me bo shtet e me majt shtet", tha, "tash për tash", tha, "osht' me randësi", tha, "shumë me randësi osht', ni shtyllë shumë e randësishme", tha, "osht' policia", thashtë, "Pasma me shkue".

Qat' ditë jemi shku kom dhanë dorëheqje te shkolla edhe ndërkohë më kanë thirrë. Jo s'pasna dhanë qat' ditë, po ma vonë pasna dhanë dorëheqje. Po jom shkue e kom mush ata aplikacionin e kemi dorëzuar për me hi në polici. Masnej kur më ka ardhë urdhnesa për me shku në shkollë... edhe qat' ditë si jom shku në shkollë kom dhanë dorëheqje prej shkollës atje edhe jom shkue në shkollën policore në Vushtrri.

Anita Susuri: A keni, a jeni penzionu si arsimtar, a si polic? Deri sa keni punu si polic?

Ajet Duli: Polic kom punu deri 2019-ten, derisa i mbusha 65 vjeç. 19 vite kom punu si polic.

Anita Susuri: Jeni penzionu si polic.

Ajet Duli: Po. Me ta thanë të drejtën unë e kom fitu penzionin edhe si arsimtar. Se u pranua ajo si kush ka punuar gjatë viteve të '90-a, na u pranua ajo stazhi edhe i bona unë 15, i kisha 15 vjet atje edhe na u numrojmë të burgut. Ni vit e gjysë për ni vit burg, si stazh. Unë i mora qato të arsimit edhe të burgut edhe dola në pension me qato. Kështu që, prej policie kom dalë në realitet.

Anita Susuri: Në polici a keni qenë si administratë apo çfarë roli?

Ajet Duli: Jo, jo, polic kom qenë.

Anita Susuri: Polic.

Ajet Duli: Polic, po. Por, ni paradoks edhe ktu. Nuk ta merr mendja çfarë çortimesh e çfarë debatesh të ashpëra si kemi zhvilluar edhe në mes veti na. Jo krahu i luftës, jo krahu i paqes. Aty shumë herë jom deshpru, jom deshpru. Se shpesh herë kom, metsha vetëm unë, krejt më dalshin kundër. Më akuzojshin, "Pse je ardhë prej arsimit e ia ke zonë vendin ni policit?" (Qeshë) Po, kështu.

Anita Susuri: E pavarësinë qysh e keni pritë? Ditën e pavarësisë? A keni qenë ndoshta me detyrë dikund a?

Ajet Duli: Po, me detyrë kom qenë. Po atë e kemi prit si çdo shqiptarë edhe na. Ishte momenti shumë i gzushëm, shumë avancues për çashtje të Kosovës edhe kemi qenë me të vërtetë shumë të kënaqun si erdh ajo ditë, erdh ai moment ku po kurorizohet diçka për neve edhe pse me vonesë shumë të madhe. Shkuan tetë vite na t'u u grind, t'u u perla mes veti. Si shkaktar i mos unitetit tonë nuk u shpallke edhe pavarësia. E di si për shembull isha me do kolegë bojshim debate, hishim qishtu në polemika. Unë e mbrojsha çashtjen ma shumë të luftës, ata ma shumë të paqes. Po kur u formu qeveria e Ibrahim Rugovës me Ramush Haradinin, të njëjtit njerëzit brenda 24 orëve kishin ndryshue si u habita, u habitsha. "More bre qishtu keni thanë për Ramushin", qishtu keni thanë për ata, "Ja qy ma në fund u tregu burrë e qy po e formojnë" (qeshë).

Anita Susuri: E qajo ditë qysh u konë për juve për shembull, pavarësia? Qysh e kujtoni?

Ajet Duli: Po dëgjo, gzimi, gzim i jashtëzakonshëm, se u pa si po kurorizohet diçka shumë e madhe. Çka ka ma e madhe sesa liria me fitue, me fitu lirinë. Me u largue edhe me shpëtue prej ni, prej ni gjakatarit si shife ti, njerëz ma kriminelat, ma gjakpirësa se serbët nuk ka bre. Çka na kanë bo neve prej 1878-ën, na kanë njëkë prej Prokuples, na kanë njëkë prej Nishi, na kanë njëkë prej Leskovci, na kanë njëkë prej Jabllanicës, prej krejt. E kemi arritë nifarë mbijete me mbijetue. E u bo lufta e sa krimet i kanë bo, e sa demonstratat e sa njerin e kanë mytë, e nëpër burgje. E sa fëminë i kanë mytë, e sa ushtartë të pafajshëm i kanë mytë, e i kanë dënu. Kemi pasë raste që kemi nejtë me ushtarë të cilët i kanë dënu. E t'u bo tulifarë provash me neve edhe në fund hala nuk janë në gjendje me pranue realitetin. Se i përcjelli do debate, osht' diçka mos me ta marrë menja. Këta janë njerëz të çmendur.

Vetëm kta mendojnë se janë të drejtë. S'ka as malazezë, as boshnjakë, as shqiptarë, as kroatë, s'ka të mirë për ta.

Anita Susuri: Zoti Ajet, unë veç ju kisha pytë edhe nëse doni diçka me shtu për fund ose që menoni që është e nevojshme me u cekë a me tregu, urdhnoni.

Ajet Duli: Pasha nerën, po më duket goxha shumë e kemi zgjatë (buzëqeshë), po.

Anita Susuri: Ishte knaqësi pra, faleminderit shumë!

Ajet Duli: Po thu a?

Anita Susuri: Po. Nëse keni diçka me shtu, urdhnoni.

Ajet Duli: Jo, veç po ju falënderoj edhe juve për durimin edhe për angazhimin e juj. Dëshiroj të keni sukses, se sukse si jonë edhe i juj osht' i përbashkët.

Anita Susuri: Po.

Ajet Duli: E ishalla ua lamë kamën e mbarë gjeneratave të reja edhe ishalla nuk e lanë nër pesë bile (buzëqeshë). Se ndëgjoni oj vajza, se ktu djem... po më duket vajza a?

Anita Susuri: Po.

Ajet Duli: E merita ma e madhe e fitores tonë është nana shqiptare që i ka lindë kah shtatë, e tetë, e nantë fëmi. I ka lindë e i ka rritë me mund e sakrificë të jashtëzakonshme edhe jemi bo faktor shumë i randësishëm. Se një ndër faktori kryesor është faktori njeri. E na kemi krijuë prej kushteve shumë të vështira. Ne kadal-kadal jemi shkollue, jemi shumë edhe jemi bo, kemi arritë ku kemi arritë.

Anita Susuri: Po. Faleminderit shumë!

Ajet Duli: Ka, ka edhe shumë çka për me u ba po duhet me qenë të knaqun edhe me qita si e kemi po m'u angazhu secilën herë për me kriju kushte edhe ma të mira, mos me u ndalë. Kryesore mos me u ndalë derisa bohet bashkimi kombëtar.

Anita Susuri: Faleminderit shumë!

Ajet Duli: Qajo është synimi i krejt (qeshë).

Anita Susuri: Po qajo është, çka tjetër. Po ju falënderoj edhe niherë për të tretën herë a të katërtën (qeshë).

Ajet Duli: Me nderë qofshi!

Anita Susuri: Ishte kënaqësi për neve.